



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Nr. 415/13 Prot.

Tiranë, më 30.09.2016

V E N D I M

Nr.126, Datë 30.09.2016

PËR

**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË
AUTORITETIN PORTUAL DURRËS “MBI ZBATIMIN E
LIGJSHMËRISË, RREGULLSHMËRISË SË VEPRIMTARISË
EKONOMIKO-FINANCIARE”**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Investimeve dhe Projekteve me Financimet e Huaja dhe Shoqërive Publike, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 15, 25 dhe 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare”, të ushtruar në Autoritetin Portual Durrës, për periudhën e veprimtarisë 01.11.2013 deri më datë 30.04.2016.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

I. Mbi realizimin e rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm.

Gjetje nga auditimi:

Këshilli Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i APD-së, përgjithësisht i kanë trajtuar me korrektësi rekomandimet e KLSH-së, të dërguara me shkresën nr. 856/24, datë 19.05.2014, por nuk kanë marrë plotësisht masa për zbatimin e tyre. Konkretisht:

-Janë rekomanduar 27 masa organizative, nga të cilat janë realizuar plotësisht 11 masa, realizuar pjesërisht ose në proces realizimi 11 masa, ndërsa 5 masa nuk janë realizuar.

-Janë rekomanduar 16 masa për shpërblim dëmi, nga të cilat janë realizuar 7 masa, realizuar pjesërisht ose në proces realizimi 6 masa, ndërsa 3 masa nuk janë realizuar.

-Për masat disiplinore: Janë rekomanduar 5 masa "Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna", 4 masa "Vërejtje me shkrim" dhe 5 masa "Largim nga puna", të cilat janë realizuar të gjitha (*Trajtuar më hollësisht në faqet 31-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Këshilli Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit Portual Durrës (APD), të marrin masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, të cilat nga auditimi rezultuan të pazbatuara, si dhe të ndjekë me vëmendje të posaçme ato të cilat janë në procese gjyqësore.

Menjëherë dhe vazhdimisht

-Këshilli Drejtues të rishqyrtojë vlerat **12,036,457 lekë** dhe **6,711 EUR**. Këto vlera kanë të bëjnë me mos-zbatimin e rekomandimit të lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 856/24 prot datë 19.05.2014, në lidhje me anulimin e Vendimit të Këshilli Drejtues nr. 30, datë 15.12.2011 "Mbi faljen e detyrimeve të lindura nga aplikimi i normës së interesit", i cili është në kundërshtim me Ligjin nr. 9130, datë 08.09.2003 "Për Autoritetin Portual", Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i procedurës administrative në Republikës së Shqipërisë" dhe VKM nr. 596, datë 10.09.2004 "Për miratimin e statutit të Autoritetit Portual Durrës dhe për riorganizimin e tij", neni 9 "Detyrat dhe të drejtat e Këshillit Drejtues". Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merret vendimi përkatës, vlerë e cila për APD dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik**.

Brenda datës 30.11.2016

II. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e Këshillit Drejtues dhe -Drejtorisë ekzekutive, si dhe bazueshmërinë ligjore të vendimeve të marra dhe realizimin e tyre.

II.1. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi me zgjedhje i vendimeve të marra nga Këshilli Drejtues për periudhën 01.06.2015 deri 27.11.2015, u konstatua se Këshilli Drejtues i APD-së, nuk ka respektuar afatet e përcaktuara në ligj për sa i përket mbledhjeve të tij. Konkretisht, për periudhën 16.07.2015 deri 06.11.2015, Këshilli Drejtues figuron të mos ketë bërë mbledhje për afro 110 ditë, pra ka kaluar periudhën prej tre muajsh pa u mbledhur. Ky konstatim, u evidentua nga procesverbalet e mbajtura në datat 01.06.2015, 17.06.2015, 16.07.2015, 06.11.2015 dhe 13.11.2015 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 38-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Këshilli Drejtues të marr masa, që në të ardhmen të respektojë afatet e mbledhjeve, konform ligjit nr. 9130, datë 08.09.2003 "Për Autoritetin Portual", neni 21, Mbledhja e Këshillit Drejtues, pika 1.

-Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Drejtoria e kontratave, çështjeve ligjore dhe koncesioneve të marrë masa, që në të ardhmen, të konceptojnë, argumentojnë me dokumentacionin përkatës ligjor, projekt-vendimet të cilat dërgohen për miratim pranë Këshillit Drejtues, duke vepruar kështu, konform rregullores së brendshme të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 8, datë 18.03.2016.

II.2. Gjetje nga auditimi:

-Nga auditimi i dosjes së Këshillit Konsultativ, u konstatua se nuk është zhvilluar asnjë mbledhje e dokumentuar. Në APD nuk ka dokumentacion që vërteton se ky këshill është i organizuar dhe funksionon në zbatim të nenit 16, pika 1 të ligjit nr. 9130, datë 08.09.2003, për këshillimin e Këshillit Drejtues të portit. Nuk ka asnjë dokumentacion ku të vërtetohet se përpara nxjerrjes së vendimeve për ndryshim tarifash portuale dhe jo vetëm, të jetë marrë këshillim nga Këshilli Konsultativ në konformitet me ligjin nr. 9130, datë 08.09.2003, i ndryshuar, neni 4 pika 5, neni 10 pika 2, neni 11 pika 1 gërma d, neni 16 pika 1 gërma a, neni 31 pika 3, përsa i përket dhënies me qira të ambienteve (*Trajtuar më hollësisht në faqet 38-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Autoriteti Portual Durrës, Këshilli Konsultativ, të marrin masat, që në të ardhmen të zhvillojnë mbledhjet dhe të dokumentohen (protokollohen) ato dhe të jepet konsulenca e nevojshme për Këshillin Drejtues, për ato çështje të cilat përcaktohen dhe tek ligji nr. 9130, datë 08.09.2003, i ndryshuar, neni 4, pika 5, neni 10, pika 2, neni 11, pika 1, gërma d, neni 16, pika 1, gërma a dhe neni 31, pika 3.

-Autoriteti Portual Durrës të marrin masa që në të ardhmen, në varësi të emergjencës për shkarkimin e makinerive me peshë mbi 5000 kg, në rastet kur nuk premtan koha, të merren masat, që të konfirmohet paraprakisht tarifa nga Këshilli Drejtues dhe më pas të miratohet po nga Këshilli Drejtues, por asnjëherë nga Drejtoria Ekzekutive duke vepruar konform ligjit nr. 9130, datë 8.9.2003 “Për Autoritetin Portual Durrës”, i ndryshuar, Kreu IV, Tarifat, neni 35, pika 4 dhe rregullores së brendshme të APD-së, miratuar me Vendimin nr. 69 datë 15.10.2012 të Këshillit Drejtues të APD-së, i ndryshuar, neni 4, faqe 7 dhe faqe 8.

Menjëherë dhe vazhdimisht

II.3. Gjetje nga auditimi:

-Për periudhën objekt auditimit, janë nxjerrë urdhra nga Drejtori i APD për “Përcaktimin e tarifës për përpunimin e anijeve me makineri mbi 5000 kg”, në kundërshtim me Ligjin nr. 9130, datë 08.09.2003 “Për Autoritetin Portual Durrës”, Kreu IV, Tarifat, neni 35 pika 4, ku citohet: “*Kur tarifat janë propozuar nga një operator që punon në port, Autoriteti Portual, pas këshillimit me Këshillin Konsultativ të portit, caktojnë një kufi më të lartë të këtyre tarifave*”. Njëkohësisht urdhrat janë në kundërshtim me rregulloren e brendshme të APD-së, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 69 datë 15.10.2012, neni 4, faqe 7 dhe faqe 8, ku përcaktohen detyrat dhe kompetencat e Këshillit Drejtues, neni 4 pika 7 gërma e, ku citohet se: “*Këshilli Drejtues, cakton tarifat për tu paguar në lidhje me anijet, mjetet, mallrat dhe personat që hyjnë apo përdorin portin dhe shërbimet që sigurohen në lidhje me to mbështetur në propozimet e Drejtorisë Ekzekutive apo Operatorëve të autorizuar*”. Pra, përveç faktit se tek neni i mësipërm, është e cituar se Drejtoria Ekzekutive bën vetëm propozime, nëse i referohemi po të njëjtës rregullore, nuk citohet në asnjë rresht tek kompetencat e Drejtorisë Ekzekutive apo dhe në nenet e tjera në përgjithësi se përveç Këshillit Drejtues, ka dhe ndonjë nivel tjetër në organigramën e APD-së që mund të vendosi për të miratuar tarifa. Përmendja në Buletinin e çmimeve të zërit “*Ngarkesa të rënda dhe me përmasa të mëdha, Makineri-pajisje, etj, mbi 5000 kg, është subjekt i negociimit mbi tarifën*”, nuk përbën aspak shkak për të anashkaluar rregulloren e brendshme të APD-së duke negociuar për tarifën dhe vendosur atë pa miratimin ose aprovimin e Këshillit Drejtues (*Trajtuar më hollësisht në faqet 38-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Nga Autoriteti Portual Durrës të merren masa që në të ardhmen, në varësi të emergjencës për shkarkimin e makinerive me peshë mbi 5000 kg, të zbatohen procedurat për miratimin e tarifave, në zbatim të ligjit nr. 9130, datë 8.9.2003 “Për Autoritetin Portual Durrës”, i

ndryshuar, Kreu IV, Tarifat, neni 35, pika 4 dhe rregullores së brendshme të APD-së, miratuar me Vendimin nr. 69 datë 15.10.2012 të Këshillit Drejtues të APD-së, i ndryshuar, neni 4, faqe 7 dhe faqe 8.

-Nga Autoriteti Portual Durrës të merren masa që në të ardhmen, të mbahet historiku i makinerive të ardhura me peshë mbi 5000 kg, me qëllim që në rast përsëritjeje të të njëjtit mall, të konsolidohet tarifa dhe të shmanget negocimi pambarimisht i tarifës për të njëjtin mall me peshën përkatëse.

Vazhdimisht

II.4. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se Këshilli Drejtues nuk ka lidhur kontratë me Drejtorin Ekzekutiv të APD^{së}, veprim në kundërshtim me nenin 21, pika 4, të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe VKM nr. 596, datë 10.09.2004 “Për miratimin e statusit të Autoritetit Portual Durrës dhe për riorganizimin e tij”.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Këshilli Drejtues të merren masa për të lidhur kontratën me Drejtorin Ekzekutiv të APD^{së}, në zbatim të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe VKM nr. 596, datë 10.09.2004 “Për miratimin e statusit të Autoritetit Portual Durrës dhe për riorganizimin e tij”.

Brenda datës 30.11.2016

III. Auditim mbi hartimin, shqyrtimin dhe miratimin e planit të biznesit nga organet drejtuese të Autoritetit Portual, Këshilli Drejtues e Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës.

III.1. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i Plan Bizneseve të miratuara në APD dhe ndryshimeve të tyre, ka rezultuar se investimet planifikohen tej kapaciteteve reale të realizimit të tyre, gjë që tregon për nivele të ultë në drejtim të planifikimit si dhe paaftësi menaxheriale në realizimin e investimeve, për të cilat APD disponon fondet përkatëse. Me synim paraqitjen e Plan Bizneseve që tregojnë mundësitë reale financiare dhe menaxhuese të APD (*Trajtuar më hollësisht në faqet 54-67, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Strukturat përkatëse të APD në bashkëpunim të ngushtë, referuar kapaciteteve dhe nevojave reale të tyre, referuar projekteve, të cilat kanë marrë formë studimi përfundimtare, të përfshijnë në Plan Bizneset përkatëse investimet prioritare dhe plotësisht të realizueshme.

Menjëherë dhe vazhdimisht

III.2. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi rezultoi se për vitin 2013, 2014, 2015 nga APD nuk ka shkresa zyrtare të dërguara në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, në të cilën Ministrit përkatës ti vihen në dispozicion pasqyrat financiare të revizionuara dhe raporte të veprimtarisë ekonomike financiare të APD, veprime që bien në kundërshtim me nenin 25/3 të ligjit nr. 9130, datë 8.09.2003.

-Gjithashtu referuar pasqyrimin të plan bizneseve, është konstatuar se legjislacioni aktual në fuqi, neni 27 i ligjit nr. 9130, datë 8.09.2003 “Për Autoritetin Portual Durrës”, nuk ka të përcaktuar afatet maksimale të hartimit dhe miratimit të plan bizneseve, gjë që ka çuar në faktin që për të tre vitet 2014, 2015 dhe 2016 plan bizneset të paraqiten në periudha të ndryshme të cilat janë aktualisht të vonshme (periudhat shkurt mars), në një kohë që këto plan biznese duhet ti paraprijnë veprimeve për realizimin e tyre dhe për rrjedhojë duhet të jenë të miratuara para fillimit të vitit përkatës.

-Në legjislacion nuk ka të përcaktuar gjithashtu afatet maksimale të paraqitjes tek Ministri përkatës të pasqyrave financiare, si dhe të analizave ekonomiko financiare të autoritetit. Me synim përcaktimin e afateve kohore të njëjta në vite, por dhe të vlefshme për realizimin e tyre për paraqitjen e plan bizneseve, si dhe të analizave ekonomike financiare dhe pasqyrave financiare tek Ministri përkatës (*Trajtuar më hollësisht në faqet 54-67, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Nga Këshilli Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, të merren masa për të hartuar rregullore të brendshme për hartimin e plan bizneseve, sipas funksioneve dhe detyrave të secilës strukturë të përfshira në këtë proces, me plan veprime sipas afateve kohore të qarta dhe të përcaktuara për çdo njësi.

-Në rregulloren e miratuar të përcaktohen afatet maksimale, ku këto plane duhet të dërgohen tek Ministri i linjës në një kohë që këto afate ti paraprijnë vitit për të cilin bëhet Plan Biznesi. Gjithashtu pjesë e përcaktimeve duhet të jenë dhe afatet e dërgimit të pasqyrave financiare dhe treguesve ekonomiko-financiar.

Menjëherë dhe vazhdimisht

III.3. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi ka rezultuar se referuar punimeve të financuara nga kredia BEI dhe BERZH punimet për Ndërtimin e Terminalit të ri të trageteve në Portin e Durrësit përfunduan me 31.05.2012 në një kohë që i gjithë projekti dhe duke përfshirë dhe fazën e dytë të rehabilitimit të Kalatave 7 dhe 8, duhet të përfundonin më 1 tetor të vitit 2010. Për rrjedhojë si rezultat i kryerjes me vonesë të punimeve në Terminalin e ri të trageteve në Portin e Durrësit, si dhe mos nisjes së punimeve në rehabilitimin e Kalatave 7 dhe 8, janë rezultuar kosto shtesë të projektit në shumën 104,821.49 euro kosto të angazhimit të paguara pas datës 1 Tetor 2010 të cilat janë paguar nga APD si dhe shuma prej 10,000 euro "Tarifa e ndryshimit" për ekzekutimin e ndryshimit nr. 3 (që është aktualisht shtyrja e afatit të marrëveshjes financiare dhe për rrjedhojë të kërkesave për disbursim deri më Dhjetor të vitit 2016) si shpenzim shtesë si rezultat i ecurisë negative të projektit, tej afateve të parashikuara dhe rënia dakord nga palët (*Trajtuar më hollësisht në faqet 54-67, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Njësia e Zbatimit të Projektit si dhe nga APD të merren të gjitha masat e mundshme teknike, organizative dhe procedurale, që punimet e parashikuara për fazën e dytë të projektit, "Rehabilitimi i kalatave 7 dhe 8", të përfundojnë brenda afateve të miratuara nga shtyrja e afatit të marrëveshjes financiare që është data 16 Dhjetor 2016. Tejkalimi i këtij afati të dakortësuar së fundmi dhe me kosto për projektin, i ngarkon këto struktura me përgjegjësi funksionale.

Menjëherë

IV. Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

IV.1. Gjetje nga auditimi:

Nga strukturat drejtuese të Autoritetit Portual Durrës, nuk janë analizuar dhe argumentuar nevojat e fuqisë punëtore. Kjo duke e lidhur me nivelin e shërbimeve që APD kryen, pasi megjithëse 80% të shërbimeve portuale janë koncesionuar, APD aktualisht ka fuqi punëtore të barabartë me 70% të strukturës së vitit 2012, kur të gjitha këto shërbime i kryente vetë APD (*Trajtuar më hollësisht në faqet 67-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Këshilli Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, si dhe Drejtoria Ekonomike Financës dhe Administrimit, të analizojnë me saktësi numrin e fuqisë punëtore aktuale dhe ta harmonizojë atë me nevojën aktuale dhe perspektivën e organizimit dhe funksionimit të Shoqërisë, duke marrë në kohë masat e nevojshme organizative, procedurale dhe ligjore në këtë drejtim, duke nisur që në fazën e rekrutimit.

Brenda datës 31.12.2016

IV.2. Gjetje nga auditimi:

-Për periudhën objekt auditimi, në APD janë punësuar gjithsej 190 punonjës, si dhe i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës 383 punonjësve. Për periudhën objekt auditimi, APD është palë në 63 procese gjyqësore, nga të cilët kanë përfunduar 34 prej tyre, ku në 18 raste APD ka humbur dhe në 16 raste APD e ka fituar procesin gjyqësor. Nga proceset gjyqësore të përfunduara për punonjësit të cilëve u është ndërprerë marrëdhënia e punës, deri më datë 30.04.2016, APD ka paguar vlerën **17,882,656.44 lekë** për 17 punonjës, vlerë e cila për APD përbën **efekt financiar negativ**.

Pavarësisht ndjekjes në të gjitha shkallët e gjykimit dhe kontestimeve nga APD të vendimeve të gjykatave, për dëmshpërblimet, si pasojë e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës, konstatohet se vendimet janë në shumicën e rasteve në favor të punonjësve të larguar dhe në të ardhmen do të shkaktojnë rëndim të situatës financiare të shoqërisë, duke cënuar zhvillimin normal të aktivitetit ekonomiko-financiar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 67-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Nga Këshilli Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, të analizohen në mënyrë të detajuar rastet e largimit nga puna, si dhe krijimin e detyrimeve të shtuara përmbartimore, duke evidentuar përgjegjësitë individuale, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për APD.

Menjëherë dhe vazhdimisht

IV.3. Gjetje nga auditimi:

-Nga auditimi u konstatua se rregullorja organizative dhe e menaxhimit të APD të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 8, datë 18.03.2016, nuk përmban procedura për rekrutimin e punonjësve të rinj dhe për vlerësimin e performancës së punonjësve, si dhe nuk përfshin përshkrimet e punës për çdo funksion të caktuar pune (*Trajtuar më hollësisht në faqet 67-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Promocionit, të marrin masa për përshtatjen e rregullores me ndryshimet në strukturën organizative, ku të jenë të përcaktuara detyrat për çdo pozicion pune, kriteret e rekrutimit të punonjësve të rinj, përputhja e nivelit të arsimimit me vendin e punës, vlerësimi i performancës së tyre, si edhe në çdo rast të merren parasysh kërkesat e Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

Brenda datës 31.12.2016

IV.4. Gjetje nga auditimi:

-Nga auditimi u konstatua se dokumentacioni i paraqitur pranë zyrës së burimeve njerëzore të APD-së nga punonjësit e saj, nuk është i plotë. Konkretisht në 57 raste, në dokumentet e paraqitura nuk disponohet lista e notave krahas diplomës përkatëse, në kundërshtim me VKM nr. 117, datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 67-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Promocionit, të konfirmojë nga Universitetet përkatëse dokumentacionin zyrtar të arsimimit (Bachelor dhe Master) për 57 punonjës për të cilët në dosjet e tyre individuale nuk disponohet lista e notave krahas diplomës. Veprim në kundërshtim VKM nr. 117, datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”. Në mënyrë analitike aneksi nr. 2, bashkëlidhur këtij Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.12.2016

IV.5. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se kriteret dhe procedurat e marrjes në punë dhe përzgjedhjes së punonjësve të Forcës së Sigurisë së Portit Durrës (FSPD), janë përcaktuar me anë të Udhëzimit të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 7, datë 11.06.2015 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së punonjësve të Forcës së Sigurisë në Portet Detare të Republikës së Shqipërisë”, i nxjerrë në zbatim të Ligjit nr. 168/2013 “Për sigurinë në anije dhe porte”, por në kundërshtim me pikën 2 të nenit 37, nxjerrja e këtij Udhëzimi nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, është kryer 1 vit e 6 muaj me vonesë.

-Nga auditimi i zbatimit të këtij Udhëzimi u konstatuan se: Procedura e zbatimit ka filluar 1-3 muaj me vonesë; janë emëruar 6 punonjës pa ndjekur procedurat e këtij udhëzimi; nuk është ndjekur nëpërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës procesi i verifikimit të anëtarëve të FSPD; për 4 punonjës të cilët janë emëruar gjatë periudhës Janar-Qershor 2015, konstatohet se kanë qenë të shpallur në kërkim për vepra të ndryshme penale si “Kontrabandë me mallra të ndaluar”, “Plagosje e lehtë me dashje”, “Vrasje me dashje e mbetur në tentativë” dhe “Trafikim i lëndëve narkotike”; si dhe drejtori i FSPD, Z.D nuk ka paraqitur dokumentacion që të provojë që nuk ka qenë nën hetim nga organet gjyqësore (*Trajtuar më hollësisht në faqet 67-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv në zbatim të planit të sigurisë portuale (për të mos lejuar cënimin e sigurisë portuale), të merren masa që punonjësit e Forcës së Sigurisë së Portit të Durrësit të jenë në përputhje me Udhëzimin nr. 7, datë 11.06.2015 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së punonjësve të Forcës së Sigurisë në Portet Detare të Republikës së Shqipërisë”.

Brenda datës 31.12.2016

IV.6. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se marrëdhëniet e punës për periudhën objekt auditimi në APD, janë rregulluar me anë të kontratës kolektive dhe kontratave individuale.

Kontrata Kolektive nr. 1851, datë 15.06.2012, është lidhur për periudhën 15.06.2012-18.06.2016, midis APD në cilësinë e punëdhënësit dhe Sindikatës së Pavarur të APD`së, në cilësinë e punëmarrësit. Por kjo referuar nenit 47 të saj, ka përfunduar më datë 18.06.2016.

Deri më 12.08.2016, datë në të cilën përfundoi auditimi, nga APD nuk kanë filluar procedurat për lidhjen e kontratës kolektive (*Trajtuar më hollësisht në faqet 67-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Këshilli Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, të marrin masa për të rinovuar kontratën kolektive të punës të punonjësve nr. 1851, datë 15.06.2012, në zbatim të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 173.

Brenda datës 31.12.2016

V. Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit sponsorizime, etj.).

V.1. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi rezultoi se biletat për udhëtimet jashtë vendit, priten nga vetë personat udhëtues. Nga APD për këto shpenzime nuk përdorej asnjë procedurë prokurimi dhe për rrjedhojë kishte marrëveshje kuadër në zbatim të ligjit për prokurimin publik, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “ Për prokurimin Publik’ të ndryshuar neni 35/1, vendimin KM nr. 918, datë 29.12.2014 “ Për rregullat e prokurimit Publik” Kreu V” Marrëveshja Kuadër”, udhëzimin APP nr. 6, datë 27.01.2015, i ndryshuar me udhëzimin nr. 7, datë 19.03.2015 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 75-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga APD të merren masa që për shumat e shpenzimeve për udhëtime jashtë vendit të cilat tejkalojnë limitin e përcaktuar të shpenzimeve për blerje të vogël, të zbatojë kriteret e përcaktuara në nenin 35/1 dhe aktet në zbatim të tij në lidhje me marrëveshjen kuadër.

Menjëherë dhe vazhdimisht

V.2. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi në APD është konstatuar se janë realizuar shpenzime për hoteleri në udhëtimet jashtë vendit, ku dokumentacioni bashkëlidhur shpenzimit jo në çdo rast ishte korrekt me kërkesat e legjislacionit në fuqi (faturë jo e konfirmuar nga shitësi) si dhe në të nuk kishte të përcaktuar numrin e yjeve të hotelit, karakteristikë që bën dhe klasifikimin e pagesave për kategori të veçanta punonjësish, në kundërshtim me vendimin e KM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin e punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 75-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Nga ana e APD në pagesat për shpenzimet e hotelit në udhëtimet jashtë vendit, të kërkojë domosdoshmërisht plotësimin ligjor dhe korrekt të dokumentacionit justifikues të shpenzimit dhe ti qëndrojë faktit të kryerjes së kësaj pagese në faturat e hotelit, vetëm për shpenzimet e fjetjes, duke zbritur çdo shpenzim tjetër, i cili në bazë të vendimit sa më sipër në fuqi, rimbursohen nga shpenzimet e dietave.

Menjëherë dhe vazhdimisht

V.3. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi në APD rezultoi se për periudhën objekt auditimi (Tetor 2013-Prill 2016), janë kryer sponsorizime në shumën 11,730,000 lekë në kundërshtim me ligjin nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet” i ndryshuar dhe Statusin aktual të autoritetit (*Trajtuar më hollësisht në faqet 75-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Nga APD dhe Këshilli Drejtues i saj, të mos kryhen propozime dhe vendimmarrje në lidhje me sponsorizimin e institucioneve të tjera shtetërore apo private, në kundërshtim me kompetencat e përcaktuara në ligjin për Autoritetin Portual, Statusin e APD dhe aktet e tjera në fuqi. Veprimtaritë e financuara jashtë funksioneve ligjore të APD i ngarkon me përgjegjësi ligjore dhe të shpërblimit të efekteve financiare.

Menjëherë dhe vazhdimisht

V.4. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi në APD për periudhën Tetor 2013 –Prill 2016, është konstatuar se janë rimbursuar një pjesë e anëtarëve të Këshillit Drejtues për pagesa për telefoninë celulare në shumat gjithsej 25,709 lekë për vitin 2013, shumën 195,683 lekë për vitin 2014, shumën 371,065 lekë për vitin 2015 dhe shumën 143,635 lekë për vitin 2016, në kundërshtim me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen me numra telefoni

celularë të personave Juridikë, Publikë” (Trajtuar më hollësisht në faqet 75-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Nga APD të ndërpritet rimbursimi i shumave për telefoninë celulare për Këshillin Drejtues dhe sekretaren e Këshillit Drejtues, të cilat bien në kundërshtim me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 864, datë 23.07.2010.

-Në funksion të realizimit të detyrave funksionale, APD të pajisë ambientet e punës së sekretares së Këshillit Drejtues me telefoni fikse dhe me shërbimin përkatës të telefonisë.

Menjëherë

V.5. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi ka rezultuar se nga APD janë marrë me sekuestro konservative, nga përmbaues privatë, për vendimet gjyqësore për 2 punonjës në shumën 1,831,987 lekë dhe 2 shoqëritë “X.1”shpk në masën 92,750,816 lekë dhe “ X.2”shpk në shumën 29,968,853 lekë, ku sekuestrot konservative janë vendosur për vendimet gjyqësore të rezultuara nga Gjykata e Apelit. Për këto sekuestro janë bërë njoftimet në Gjykatën e Lartë nga APD për anulimin e tyre, por nga gjykata nuk ka pasur vendimmarrje të pezullimit. Gjithashtu të dyja shoqëritë dhe të dy punonjësit janë në proces gjykimi me APD, në Gjykatën e Lartë, si rezultat të rekursit të bërë nga APD të vendimeve të Gjykatës së Apelit (Trajtuar më hollësisht në faqet 75-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Nga Drejtoria e kontratave, çështjeve ligjore dhe koncesioneve, e cila merret me ndjekjen e çështjeve gjyqësore, të ndiqen me përgjegjshmëri maksimale çështjet sa më sipër, duke paraqitur çdo provë e dokument në favor të fitimit të çështjeve nga APD.

-Nga APD me përfundimin e procesit të kihet në konsideratë rimbursimi i shumave të përfituara padrejtësisht nga dy punonjësit për periudhën që janë ripunësuar në APD.

Menjëherë dhe vazhdimisht

V.6. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi ka rezultuar se nga APD të gjitha urdhër shpenzimet për pagesat e kryera nëpërmjet bankës janë të firmosura nga përgjegjësit e sektorit të financës dhe nga Drejtori Ekzekutiv sipas emërimeve në periudhën objekt auditimi, në kundërshtim me nenin 9 dhe 12 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “ Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ku urdhër shpenzimet duhet të firmoseshin nga Nëpunësit zbatues dhe autorizues të periudhës objekt auditimi. Nga APD, në bankat përkatëse të nivelit të dytë, në kundërshtim me ligjin dhe emërimet sa më sipër, janë depozituar firmat e Përgjegjësit të Financës dhe Drejtorit Ekzekutiv për periudhat sipas emërimeve të pa deleguar dhe jo firmat e nëpunësit zbatues dhe Autorizues (Trajtuar më hollësisht në faqet 75-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga APD të bëhet përputhshmëria e firmave të depozituara në bankat e nivelit të dytë me funksionet e Nëpunësit Zbatues dhe Autorizues të emëruar në autoritet, ose punonjësve të deleguar konform zbatimit të ligjit.

Menjëherë

VI. Organizimi dhe mbajtja e evidencës kontabile, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e pasqyrave financiare nga organet drejtuese të Autoritetit Portual, si dhe dërgimi e miratimi i tij në institucionet e prapë. Analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit.

Inventarizimi fizik i pasurisë, zbatimi i afateve, cilësia e inventarizimeve, si dhe mbyllja e sistemimi i rezultateve në pasqyrat financiare vjetore.

VI.1. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi ka rezultuar se nga autoriteti, në faturimet e kryera, nuk është përdorur kursi ditor i konvertimit në monedhën përkatëse, por kursi i datës së fundit të muajit paraardhës, mbështetur kjo dhe në rekomandimin e ekspertit, i cili ka bërë përshtatshmërinë e përdorimit të sistemit “ Orakle me nevojat e APD. Ky veprim bie në kundërshtim me SNK 21 i cili përdoret dhe në SKK. Gjithashtu rekomandimi i lënë nga eksperti nuk i përmbahet korrektësisht standardit dhe s’mund të përdoret në kushtet kur kurset e këmbimit janë të lëvizshme brenda periudhave kohore të shkurtra (*Trajtuar më hollësisht në faqet 110-129, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga APD faturimet e kryera të realizohen me kursin ditor të raportuar nga Banka e Shqipërisë, rekomandim ky i lënë nga KLSH dhe në auditimin e mëparshëm. Në rastet e veçanta, të pamundësisë së përdorimit të kursit ditor, të përdoret kursi mesatar i ditëve të fundit deri në një javë, ashtu siç bëhet orientimi dhe nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

Menjëherë dhe vazhdimisht

VI.2. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi i pasqyrave financiare të APD ka rezultuar, se shoqëria nuk ka përgatitur pasqyra financiare të konsoliduara si rezultat i ekzistencës së filialit në Kosovë, dhe ku APD kishte nisur procedurat e likuidimit gjatë vitit 2014. Referuar pasqyrës së balancës së të ardhurave dhe shpenzimeve të këtij filiali, identifikohen pagesa të konsiderueshme për shpenzime udhëtimi, telefon, shpenzime qiraje, shpenzime paga, shërbime kontabiliteti, kapital i anëtarësisë, pagesës së taksës së shitjes së pagueshme etj., të cilat janë të konsiderueshme në krahasim me pagesat për reklamim e promovim, qëllim për të cilën ishte krijuar ky filial. Gjithashtu për periudhën mbas likuidimit të filialit, grupit të auditimit nuk ju dha informacion mbi raportin e likuidimit, dorëzimin e dokumentacionit apo inventarit të aseteve të kësaj dege, megjithë kërkesën e bërë. Referuar informacionit të marrë në APD rezultoi se nuk ka program auditimi në vitin 2012, 2013 apo 2014 për shpenzimet e kryera në këtë filial, kundrejt fondeve të çelura nga ky autoritet dhe nga ana e hartuesve të pasqyrave financiare e gjithë shuma e transferuar për Kosovën, ka kaluar si provigjion. Për provigjionin e krijuar grupit të auditimit nuk ju paraqit vendimmarrje të marrë nga Drejtimi i APD, veprim që bie në kundërshtim me standardin e pranuar në hartimin e pasqyrave financiare “Politika të rëndësishme kontabël”(f) Provizionet (*Trajtuar më hollësisht në faqet 110-129, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Nga APD të programohet proces auditimi i dokumentacionit të arkivuar në APD, për të gjithë shumën e transferuar për gjatë tre viteve (2011,2012,2013) në masën 156,000 Euro, raportet e likuidimit, si dhe dorëzimi i aseteve në zbatim të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësinë e Sektorit Publik”.
-Nga ana e APD në rast të rezultateve me konstatime në shpërdorim të fondeve të transferuara dhe përdorim të tyre jo në përputhje me misionin e filialit dhe në kundërshtim me aktet ligjore në fuqi, të bëhet inicimi i padisë penale kundrejt përgjegjësve, në zbatim të kompetencave të përcaktuara për Titullarin e njësisë në drejtim të ruajtjes dhe mirë menaxhimit të aseteve, në udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësinë e Sektorit Publik”, dhe për rezultatet e auditimit të njoftohet KLSH.

Brenda datës 31.12 2016.

VI.3. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi ka rezultuar se APD nuk dispononte dokumente hipotekore për të gjitha ndërtesat, të cilat janë rezultuar të prishura në vitet e mëparshme, apo të prishura nga inventarizimi i vitit 2014. Gjithashtu nga zyra teknike e APD nuk u paraqit dokumentacion që të argumentonte gjendjen e prishur të aseteve, të rezultuara të tilla nga inventarizimi i fundit, si rezultat i realizimit të projekteve në APD në vitet e mëparshme, veprime këto që bien në kundërshtim me ligjin 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” me detyrimet e master-planit të miratuar me vendimin e KM nr. 546, datë 28.5.2009. Gjithashtu prishja apo nxjerrja nga përdorimi i aseteve ndërtesa, kalata, sheshe, mur, etj., pa dokumentin e pronësisë, bie në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e Aktiveve në Njësinë e Sektorit Publik” pika 111. Në APD nuk ka një plan rilevimi të shtrirjes së saj, që është një nga kushtet që kërkon legjislacioni për informimin nga ZVRPP me gjendjen e certifikatave të pronësisë në administrim, pronësi të saj apo të personave privatë e shtetërore të tjerë (*Trajtuar më hollësisht në faqet 110-129, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Nga APD të merren masat që të realizojë kërkesat që kërkon ZVRPP për pajisjen e autoritetit me informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për pronat në ambientet ku ky autoritet kryen veprimtarinë, ku një nga kërkesat kryesore është dhe plan rilevimi nga ING. Topograf të licencuar për secilin objekt sipas plan vendosjes së miratuar bazuar në HTR të azhurnuar të ZVRPP.

-Nga APD të bëhet pajisja me dokumentacionin e nevojshëm të pronësisë për të gjitha pronat e kaluara me Vendime të Këshillit të Ministrave dhe ku për të cilat nuk janë kryer për të gjitha kalimet, veprimet përkatëse me ZVRPP.

Brenda datës 30.06. 2017

VI. 4. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi rezultoi se gjendja debitore në APD në fund të vitit 2015 është e lartë, pavarësisht se këto detyrime janë më të vogla nga vitet e mëparshme dhe janë reduktuar deri me datën 1.06.2016. Shuma e detyrimeve më 31.12.2015 është 385,379,649.1 lekë e reduktuar më 1.06.2016 në masën 189,973,212.6 lekë. Theksojmë se një pjesë e detyrimeve, detyrimet nga vitet 1996-2009, janë pa shpresë arkëtimi. Për këto detyrime dhe të tjera janë parashikuar provigjione në masën -121,417,679 lekë, pa ndryshuar nga viti 2014. Për periudhën objekt auditimi nuk ka në Këshill Drejtues një analizim në mënyrë të veçantë të detyrimeve debitore dhe vendimmarrje ligjore në këtë drejtim.

Gjithashtu nga ekspertët kontabël të cilët kanë audituar pasqyrat financiare një nga sugjerimet është, që nga APD të ketë vendimmarrje në drejtim të kalimit në humbje të detyrimeve pa shpresë arkëtimi (detyrime të viteve 1996-2009), gjë që aktualisht në APD nuk ka ndodhur, kompetenca këto të përcaktuara në ligjin nr. 9130, datë 08.09.2003 “Për Autoritetin Portual” dhe Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 69, datë 15.10.2012 “Mbi miratimin e rregullores “Për organizimin dhe menaxhimin e Autoritetit Portual Durrës” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 110-129, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Këshilli Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, të analizojë gjendjen debitore dhe kreditore më datë 31.12.2015, si dhe të marrë masat e nevojshme për reduktimin e tyre, në zbatim të Ligjit nr. 9130, datë 08.09.2003 “Për Autoritetin Portual”, nenet 15 dhe 25, VKM nr. 596, datë 10.09.2004 “Për miratimin e statutit të Autoritetit Portual Durrës dhe për riorganizimin e tij”, neni 9, pika 14, neni 14, pika 8, dhe Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 8,

datë 18.03.2016 “Mbi miratimin e rregullores “Për organizimin dhe menaxhimin e Autoritetit Portual Durrës”.

Brenda datës 31.12.2016

VII. Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet për investime, për blerje mallrash e shërbimesh, si dhe zbatimi i kontratave.

VII.1. Gjetje nga auditimi

Në tre raste objektet janë ndërtuar pa leje ndërtimi, veprim në kundërshtim me VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për disiplinimin dhe kontrollin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Ligjin 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit ” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 129-202, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të merren masa që investimet për ndërtimet dhe rikonstrukcionet të kryhen me leje ndërtimi, në zbatim të Ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit.

Vazhdimisht

VII.2. Gjetje nga auditimi

Në përlllogaritjen e vlerës të kontratës, nuk janë harmonizuar metodat e vendosura në aktet ligjore e nënligjore të prokurimeve, si dhe çmimet e botuara nga INSTAT-i, çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, janë mbështetur në studimin e tregut dhe sigurimin e ofertave për të njohur nivelin aktual të tregut, por nuk është dokumentuar nëse nga AK, janë kryer analizat e kostos së mallrave që do të prokurohen, duke krahasuar elementët e mësipërm me specifikimet teknike, në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, neni 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”. Në 1 rast nga përlllogaritja e gabuar e vlerës së kontratës, është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën **615,360 lekë**.

-Në hartimin e dokumenteve të tenderit, nuk janë dhënë argumentime mbi vendosjen e çdo kriteri të veçantë për kualifikim. Ky veprim bie në kundërshtim me Rregullat e Prokurimit Publik, të miratuara me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”.

-Specifikimet teknike nuk janë hartuar plotësisht në përputhje me nenin 23 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pasi ato nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë marke apo emri të veçantë, patente, vizatimi ose tipi, origjinë specifike, prodhuesi ose sipërmarrje shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “*ose ekuivalent*” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

-Anulimi i procedurave të prokurimit nga autoriteti kontraktor, është kryer pa analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për shkaqet subjektive që vërehen në procedurat e anuluar, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”. Arsyet për anulimin e procedurës duhet të jenë mjaftueshmërisht bindëse dhe duhet tu komunikohen të gjithë pjesëmarrësve në procedurën e prokurimit. Autoriteti kontraktor publikon njoftimin për anulimin e procedurës së prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç është publikuar njoftimi i kontratës, jo më vonë se 5 ditë nga data e marrjes së vendimit për anulim.

Në 25 procedura tenderimi, kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer **në mënyrë të padrejtë**, veprim në kundërshtim me Ligjin

nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurës administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 115-120, çka ngarkon me përgjegjësi komisionet e vlerësimit të ofertave. Në 5 raste shkelja e procedurave të prokurimit ka sjellë dëm ekonomik në vlerën **2,320,435 lekë**.

-Në një rast investimi, kolaudimi i punimeve është realizuar nga shoqëria “X.3” sh.p.k, e cila është e njëjta shoqëri që ka realizuar edhe projektimin e këtij investimi. Akti i kolaudimit është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për disiplinimin dhe kontrollin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 12 ku citohet se, kolaudimi i objektit kryhet nga kolaudatori që është person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse për kolaudim punimesh dhe që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me projektimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit të objektit që do të kolaudojë (*Trajtuar më hollësisht në faqet 129-202, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Për rritjen e efikasitetit në shpenzimet publike, duke zhvilluar procedura prokurimi në përmbushje të kriterëve ligjore, kapaciteteve ekonomike, financiare dhe profesionale, në përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, duke siguruar që Autoriteti Kontraktor të pranojë oferta të cilat janë të përballueshme, të qëndrueshme, të pakushtëzuara dhe të plotësimit të nevojave të saj:

-Autoriteti Kontraktor, në vijim duhet të hartojë kërkesa të veçanta për kualifikim, që të sigurojë konkurrencën e nevojshme, si një nga parimet bazë të prokurimit në blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punimeve, për të arritur rezultate të dëshirueshme në efektivitetin e përdorimit të fondeve publike. Këto kërkesa duhet të kenë në konsideratë edhe faktin që të kushtëzojnë kualifikimin e operatorëve në vartësi të shlyerjes/ose jo të detyrimeve financiare ndaj APD-së, zgjidhjes së njëanshme të kontratave, ose mos përmbushjes të të gjitha detyrimeve kontraktore, si dhe duhet të reflektojnë kërkesat për përputhshmërinë e produkteve me kërkesat ligjore të sigurisë që mbulojnë fushën apo produktin. Ky rekomandim mbështetet në frymën e ligjit për prokurimin publik, si dhe në rregullat e prokurimit publik;

-Nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i APD t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ i operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi në disa raste konstatohet jo korrekt;

-Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të vlerësojë drejtë kërkesat për kualifikim dhe specifikimet teknike të miratuara në dokumentet e tenderit, duke u mbështetur në dokumente zyrtare dhe fletë analiza të lëshuara nga organet kompetente;

-Për të përcaktuar përgjegjësinë individuale, të bëhet ndarja e detyrave ndërmjet anëtarëve të Njësisë së Prokurimit dhe të miratohet nga titullari i Autoritetit Kontraktor;

-Anulimi i procedurave të prokurimit nga autoriteti kontraktor, të kryhet duke analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për arsyet e procedurave të anuluar, në zbatim të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”. Arsyet për anulimin e procedurës duhet të jenë mjaftueshmërisht bindëse dhe duhet tu komunikohen të gjithë pjesëmarrësve në procedurën e prokurimit.

Vazhdimisht

VIII. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit.

VIII.1. Gjetje nga auditimi

Autoritetit Portual Durrës, nuk ka marrë masa për hartimin e planin për ngritjen e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 202-207, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Nga Këshilli Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, të merren masa për të ngritur një sistem të mirëfilltë për monitorimin e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, duke evidentuar problematika, përgjegjësi dhe rekomandime me afate konkrete, për një monitorim në vijueshmëri të këtij procesi.

-Departamenti i Auditit të Brendshëm të përcaktojë fushat, sistemet dhe objektivat e auditimit duke u orientuar më shumë nga problematikat kryesore të evidentuara nga auditimi i KLSH-së, për ta bërë sa më efektive veprimtarinë e tyre në ndihmë të mirëmenaxhimit të kësaj shoqërie publike.

Menjëherë dhe vazhdimisht

VIII.2. Gjetje nga auditimi

-Në rregulloren e brendshme të Autoritetit Portual Durrës, nuk janë të përfshirë plotësisht kërkesat e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 202-207, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Këshilli Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, të rishikohet Rregullorja Organizimit dhe Funkcionimit të Brendshëm të APD, dhe të bëhen rregullimet e nevojshme në lidhje me përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve sipas drejtorive deri në nivel specialisti, në zbatim të kërkesave të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”.

Brenda datës 31.03. 2017

IX. Respektimi i dispozitave ligjore në lidhjen dhe zbatimin e kontratave me subjektet private që operojnë në port, si dhe zbatimi i tarifave përkatëse.

IX. 1. Mbi zbatimin e marrëveshjeve koncensionare

a. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se Kompania X.4 (Terminali i trageteve) ka në përdorim pajisje të sistemit të checkinit elektronik në pronësi të APD në vlerën **12,537,316 lekë**, dhe nuk paguan asnjë detyrim ndaj APD (*Trajtuar më hollësisht në faqet 207-237, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Këshilli Drejtues, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës të marrin në analizë, të rishqyrtojnë dhe të rinegociojnë Marrëveshjen me Kompaninë X.4 (Terminali i trageteve), me qëllim që të marri në përdorim pajisjet e sistemit të checkinit elektronik në pronësi të APD, në vlerën **12,537,316 lekë**, të cilat kjo Kompani po i përdor dhe likuidojnë detyrimet përkatëse për llogari të APD.

Brenda 31.12.2016

b. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se kompanitë koncensionare X.5, X.6 dhe X.4, nuk kanë zbatuar detyrimin kontraktor për të investuar në терминаlet respektive të marra me konçesion. Konkretisht:

Detyrimi që Konçesionari “X.5” duhet të investojë për të gjithë periudhën e koncesionit, është në vlerën 2,069,371,737 lekë, deri me datën 30.04.2016 nuk provohet të ketë investuar asnjë vlerë. Nuk ka raportim zyrtar nga njësia e zbatimit të projektit pranë MTI, si autoritet kontraktor për këtë kontratë koncesionare për investimin e kryer.

Detyrimi që Konçesionari X.4 duhet të investojë për të gjithë periudhën e koncesionit, është në vlerën 4,143,000 EUR, deri me datën 30.04.2016 nuk provohet të ketë investuar asnjë vlerë. Nuk ka raportim zyrtar nga njësia e zbatimit të projektit pranë MTI, si autoritet kontraktor për këtë kontratë koncesionare, për investimin e kryer.

Detyrimi që Konçesionarit X.6 duhet të investojë për të gjithë periudhën e koncesionit, është në vlerën 32,500,000 USD, deri me datën 30.04.2016 nuk provohet të ketë investuar asnjë vlerë. Nuk ka raportim zyrtar nga njësia e zbatimit të projektit pranë MTI, si autoritet kontraktor për këtë kontratë koncesionare, për investimin e kryer.

Për këtë situatë, nga APD i është kërkuar informacion zyrtar Njesisë së zbatimit të projektit pranë MTI, me shkresat nr. 563, datë 16.02.2016 dhe nr. 1737, datë 13.06.2016, e cila nuk ka vënë në dispozicion asnjë lloj informacioni në lidhje me investimet e kryera nga kompania koncesionare X.5, edhe pse është një detyrim kontraktual.

Për këtë situatë, nga APD i është kërkuar informacion zyrtar Njesisë së Zbatimit të Projektit pranë MTI, me shkresat nr. 2300, datë 16.07.2015 dhe nr. 3804, datë 23.12.2015, e cila nuk ka vënë në dispozicion asnjë lloj informacioni në lidhje me investimet e kryera nga kompania koncesionare X.6, edhe pse është një detyrim kontraktual.

Deri më datë 12.08.2016, datë në të cilën përfundoj auditimi, nga APD nuk konfirmohet asnjë investim i kryer prej tyre (*Trajtuar më hollësisht në faqet 207-237, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të prezantohen në organet drejtuese vlerat e investimeve që kompanitë koncesionare kanë detyrimin kontraktor për ti investuar, konkretisht Konçesionari X.5 në vlerën **2,069,371,737 lekë**, Konçesionari X.4 në vlerën **4,143,000 EUR** dhe Konçesionari X.6 në vlerën **32,500,000 USD**. Deri më datë 12.08.2016, nga APD nuk konfirmohet asnjë investim i kryer prej tyre.

Sipas opinionit tonë, marrëveshjet me kompanitë koncesionare të përshkruara më sipër, duke mos kryer investimet e përcaktuara në kontratat koncesionare respektive, kanë dëmtuar interesat e ligjshme të Shtetit, si dhe kanë favorizuar këto kompani, çka përbën jo vetëm shkelje të rëndë të legjisllacionit në fuqi, por është dhe një shprehje flagrante e mos zbatimit të ligjit.

Në rast të mos-kryerjes së investimeve të përcaktuara në marrëveshjet koncesionare, të kryhet pezullimi i menjëhershëm i marrëveshjeve koncesionare, deri në kryerjen e investimeve sipas marrëveshjes, e në rast të kundërt të zbatohen procedurat ligjore për sanksionet përkatëse.

IX. 2. Mbi zbatimin e kontratave me subjektet spedicionere që operojnë në port.

a. Gjetje nga auditimi:

Me vendimin nr. 23, datë 01.06.2015 “Mbi rinovimin/nënshkrimin e kontratës me shoqërinë “X.7” SHPK”, Këshilli Drejtues i APD ka vendosur rinovimin e kontratës me objekt mbulimin e shërbimeve të ngarkim-shkarkimit të mallrave në port për një periudhë tjetër 10 (dhjetë) vjeçare e vlefshme deri më datë 31.05.2025. Në lidhje me këtë rinovim kontrate, u konstatua se:

-Vendimi i marrë për zgjatjen e kontratës është në kundërshtim me opinionin e dhënë nga drejtuesit e APD me relacionin nr. 1472/2, datë 28.05.2015.

-Shoqëria “X.7” SHPK në datën e lidhjes së kontratës ka **detyrime të papaguara në vlerën 54,380,344.00 lekë**.

Referuar observacionit të dërguar nga shoqëria "X.7" SHPK, me shkresën nr. 120 prot, datë 30.09.2016, protokolluar në KLSH me nr. 415/11, datë 30.09.2016, në lidhje me Projektraportin e Auditimit, si dhe konfirmuar nga departamenti i financës dhe ekonomisë të APD-së, për periudhën 13.05.2011-30.09.2016, shuma që APD i ka faturuar shoqërisë "X.7" SHPK është në vlerën 461,928,284 lekë, nga të cilat janë paguar nga kjo shoqëri deri më datë 30.09.2016, shuma 400,031,882 lekë, pra debia që shoqëria "X.7" SHPK ka ndaj APD-së është në vlerën **61,896,402 lekë**, shifër e cila në krahasim vetëm me detyrimin e trashëguar ndaj APD-së është ulur në shumën 10,826,056 lekë ose 14.8% (*Trajtuar më hollësisht në faqet 207-237, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Këshilli Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, të rinegociojnë kushtet e marrëveshjes me shoqërinë "X.7" Sh.p.k, për të bërë të mundur zgjidhjen përfundimtare të detyrimeve financiare të prapambetura.

X. Administrimin e mbetjeve urbane të rrezikshme (Problemet mjedisore).

X.1. Gjetje nga auditimi:

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit, u konstatua se Autoriteti Portual Durrës, ka lidhur kontrata për depozitim të qymyrit tek kalatat me nr. 1 dhe nr. 2, kalata këto të cilat nuk përdoren për mallra rifuxho si qymyr apo çimento. Nga inspektimi faktik në terren më 31.05.2016, nuk u konstatua asnjë masë e marrë për parandalimin e ndotjes dhe riparimin e situatës ekologjike dhe me rrezik për akuariumin por edhe pasi në distancë të afërt po shkarkohej grurë (*Trajtuar më hollësisht në faqet 237-242, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Autoriteti Portual Durrës, Drejtoria Operacionale, Drejtoria e Mjedisit, të marrin masat, që në të ardhmen, të bashkëpunojnë me qëllim evidentimin në kohë të ndotjeve dhe mos-lejimin e operimit të mallrave të ndaluara në kalatat, duke nxjerr urdhrat përkatës, për eliminimin e pasojave negative për mjedisin, duke vepruar në këtë mënyrë konform Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 69, datë 15.10.2012, nenit 7, pika 2 dhe pika 5, nenit 7.1, Sektori i Dispecerisë Qendrore, pika 1, por dhe të rregullores së rishikuar sipas Vendimit nr. 8, datë 18.03.2016, nenit 23, pika 2, nenit 23.1, Sektori i Dispecerisë Qendrore, pika 1, pika 3 dhe pika 19.

Menjëherë dhe vazhdimisht

B.1 MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi:

Mos vënien në punë të peshores elektronike me vlerë investimi **47,994,000 lekë**, pasi ky investim, nuk ka justifikuar kryerjen e këtij shpenzimi, që ka të bëjë me instalimin e sistemit të integruar të peshimit elektronik, i cili duhet të përshpejtojë procedurat e brendshme të operimit, rritjen e sigurisë së veprimeve të brendshme, mirë administrimin e të ardhurave të Autoritetit Portual, si dhe rritjen e cilësisë dhe shpejtësisë së shërbimit përkundrejt operatorëve, për pos kësaj në Terminalin e kontejnerëve në vitin 2015 është ndërtuar një peshore tjetër, pa asnjë dokumentacion, dhënë me qira ose me enfiteozë të sipërfaqes së ndërtimit, ose blerë sipërfaqen e truallit që ajo zë, leje ndërtimi etj. Sipas deklarimit verbal të R. K me detyrë përgjegjës i sektorit të kontratave koncensionare, kjo peshore është ndërtuar nga Dogana Durrës. N.q.s do të jetë i vërtetë ky fakt, Dogana në këtë terminal disponon dy peshore dhe APD disponon dy peshore elektronike.

Pra të ardhurat nga peshimi i ngarkesave në përpunimin e anijeve kalojnë për llogari të Doganës dhe jo APD.

Vlera 47,994,000 lekë për APD dhe Buxhetin e Shtetit përbën dëm ekonomik (*Trajtuar më hollësisht në faqet 31-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Këshilli Drejtues të shqyrtojë vlerën **47,994,000 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me mos vënien në punë të peshores elektronike me vlerë investimi **47,994,000 lekë**, pasi ky investim, nuk ka justifikuar kryerjen e këtij shpenzimi, që ka të bëjë me instalimin e sistemit të integruar të peshimit elektronik, i cili duhet të përshpejtojë procedurat e brendshme të operimit, rritjen e sigurisë së veprimeve të brendshme, mirë administrimin e të ardhurave të Autoritetit Portual, si dhe rritjen e cilësisë dhe shpejtësisë së shërbimit përkundrejt operatorëve. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merret vendimi përkatës, Vlera **47,994,000 lekë** për APD dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik**.

Në rast mos-zbatimi të këtij rekomandimi, KLSH do të denoncojnë përgjegjësinë ligjore dhe ekonomike të personave zyrtarë të përfshirë në këtë proces, që me veprimet dhe mos veprimet e tyre në zbatim të kompetencave që ju jep ligji, kanë kryer përmbushjen ose jo të rregullt të detyrës, me pasojë prekjen e interesave ligjshme të APD dhe të Shtetit.

Brenda datës 30.11.2016

2. Gjetje nga auditimi:

Këshillit Drejtues me vendim nr. 25, datë 22.07.2014, ka miratuar pagesën në vlerën **48,704.06 EUR**, për llogari të projektit “Promoting Connectivity of Internet Broadband in the Accursed Mountain Border Area”, si detyrim financiar i APD-së kundrejt Komisionit European në kuadër të zbatimit të kontratës (grant contract) nr. 2009/223-213, datë 14.09.2009, vlerë të cilën e ka kaluar nëpërmjet llogarisë të Ministrisë së Inovacionit dhe Administratës Publike. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit, u konstatua se APD-ja, nuk disponon asnjë shkresë zyrtare ose dokumentacion ligjor e justifikues, si dhe as edhe një fakt të vetëm, ku të vërtetohej (provohej) se APD-ja e ka përfituar vlerën e 48,704.06 EUR (përfshi dhe kamatëvonesat), si paradhënie nga Komisioni European, për kontratën e lidhur me nr. 2009/223-213, datë 14.09.2009 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 38-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Këshilli Drejtues të rishqyrtojë vlerën **48,704 EUR**. Kjo vlerë ka të bëjë me likuidimin për llogari të projektit “Promoting Connectivity of Internet Broadband in the Accursed Mountain Border Area”, si detyrim financiar i APD-së kundrejt Komisionit European në kuadër të zbatimit të kontratës (grant contract) nr. 2009/223-213, datë 14.09.2009. Për këtë likuidim APD-ja, nuk disponon asnjë shkresë zyrtare ose dokumentacion ligjor por as edhe një fakt i vetëm, ku të vërtetohej (provohej) se APD-ja ka përfituar vlerën e 48,704,06 Euro (përfshi dhe kamatëvonesat), si paradhënie nga Komisioni European për kontratën e lidhur me nr. 2009/223-213, datë 14.09.2009. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merret vendimi përkatës, vlerë e cila për APD dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik**.

Brenda datës 30.11.2016

3. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se marrëveshja nr. 614 prot, datë 25.02.2015 e lidhur ndërmjet APD, Drejtorisë së Përgjithshme Detare dhe Shoqërisë “X.8”, për vlerësimin e planit të sigurisë, është kryer pa procedurë prokurimi, veprim në kundërshtim me nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, I ndryshuar, neni 1. Ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore.

1. Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik”

Pretendimi për karakterin sekret të këtij shërbimi është keq interpretim i ligjit të mësipërm dhe është bërë me qëllim për të abuzuar me fondet publike. Nëse i referohemi ekstraktit të regjistrit tregtar, aksionet e kësaj shoqërie 25 % zotërohen nga aksionar shqiptar, **ndërsa 75 % e tyre zotërohet nga aksionar të huaj të panjohur dhe të pa autorizuar nga organet e ngarkuara me ligj për sigurinë kombëtare, në këto kushte grupi i auditimit shprehet me rezervë për ruajtjen e sigurisë kombëtare.**

Shtuar dhe faktit se ky plani sigurie portuale është cënuar në rastet si më poshtë:

-Për 4 punonjës të cilët janë emëruar gjatë periudhës Janar - Qershor 2015, të cilët referuar shkresës nr. 4022/1, datë 24.11.2015, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, kanë qenë të shpallur në kërkim për vepra të ndryshme penale si “Kontrabandë me mallra të ndaluar”, “Plagosje e lehtë me dashje”, “Vrasje me dashje e mbetur në tentativë” dhe “Trafikim i lëndëve narkotike”. Emërimi i këtyre personave në detyra të ndryshme pranë FSPD, është kryer në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 242, datë 23.04.2014 “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së punonjësve të forcave të sigurisë në portet e Republikës së Shqipërisë”, neni 2, pika 5.

-Porta që lidh APD me portin e ri të peshkimit, pasi kjo portë nuk përfshihet në planin e sigurisë detare, të miratuar nga Ministri, si autoriteti më i lartë i sigurisë portuale. Theksojmë se porti i ri i peshkimit nuk përfshihet në planin e sigurisë së Portit të Durrësit, nuk implementon kodin ISPS, si dhe mjete ujore që operojnë në këtë port nuk kontrollohen nga FSP por nga policia kufitare dhe institucione të tjera në juridiksionin detar. Më datën 20.07.2016, u krye kontroll i befasishtëm dhe kjo portë nuk ishte e ruajtur me punonjës të FSPD.

-Ekzistenca e dy portave hyrëse dhe dalëse në terminalin lindor, të cilat nuk përfshihen në planin e sigurisë detare, të miratuar nga Ministri, si autoriteti më i lartë i sigurisë portuale. Porta nr. 5, bazuar në rekomandimin e kompanisë që ka kryer vlerësimin e rrezikut në Portin e Durrësit, duhet të ishte mbyllur, ndërsa porta e emergjencës duhet të funksionojë si hyrëse dhe dalëse për në terminalin lindor.

-Futja në Portin e Durrësit të punonjësve të Shoqërisë “X.9” shpk për zbatimin e punimeve në kalatën 7 dhe 8, të pa përfshira në kontratën e lidhur ndërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe Kompanisë X.10 datë 12.04.2014, për zbatimin e këtyre punimeve, në aneks kontratën është parashikuar vetëm përdorimi i makinerive dhe pajisjeve.

-Ekzistenca në terminalin e kontejnerëve (X.6) e një peshoreje. Kjo peshore nuk është e përfshirë në protokollin e dorëzimit, të kompanisë koncensionare X.6, si dhe APD nuk disponon asnjë dokument shkresor për ndërtimin e kësaj peshore, si janë futur mjete për ndërtimin e saj, personeli inxhinieriko-teknik, cila firmë e ka ndërtuar, për llogari të kujt është ndërtuar etj.

Pra vetëm plan sigurie portuale nuk mund të konsiderohet

Për pos kësaj; Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit, nuk vërtetohet kryerja e këtij shpenzimi, pasi produkti (plani i sigurisë) nuk u vu në dispozicion të grupit të auditimit, me pretendimin e sekretit të sigurisë portuale, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 26 dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 35, gërma a, pika 36, Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 6. ***Vlera 126,000 EUR përbën dëm ekonomik për APD dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet (Trajtuar më hollësisht në faqet 129-202, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).***

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Këshilli Drejtues të shqyrtojë vlerën **126,000 EUR**. Kjo vlerë ka të bëjë me nënshkrimin dhe zbatimin e marrëveshjes nr. 614 prot, datë 25.02.2015 të lidhur ndërmjet APD, Drejtorisë së Përgjithshme Detare dhe Shoqërisë “X.8”, për vlerësimin e planit të sigurisë, e cila është kryer pa procedurë prokurimi, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, si dhe nuk vërtetohet kryerja e këtij shpenzimi, pasi produkti (plani i sigurisë) nuk u vu në dispozicion të grupit të auditimit, me pretendimin e sekretit të sigurisë portuale, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Brenda datës 30.11.2016

4. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga shoqëria “X.11” sh.p.k & “X.12” sh.p.k me objekt “Ndërtimi i segmentit rrugor Hyrja nr. 4, Kalata Lindore”, viti 2015, u konstatua se dokumentacioni teknik i zbatimit dhe kolauditimit të punimeve të ndërtimit nuk është i plotë dhe i saktë, duke krijuar një dëm ekonomik për llogari të APD-së dhe Buxhetit të Shtetit në **vlerën 2,963,980 lekë** (*Trajtuar më hollësisht në faqet 129-202, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 2,963,980 lekë** nga shoqëria “X.11” sh.p.k & “X.12” sh.p.k për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës me objekt “Ndërtimi i segmentit rrugor Hyrja nr. 4, Kalata Lindore”, viti 2015, vlerë e cila për Autoritetin Portual Durrës dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik**.

Brenda datës 31.12.2016

5. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga “shoqëria “X.11” sh.p.k & “X.12” sh.p.k me objekt “Zbatim-Furnizim Vendorsje e kalunave në kalatat 1,2,3 dhe 4”, viti 2015, u konstatua se dokumentacioni teknik i zbatimit dhe kolauditimit të punimeve të ndërtimit nuk është i plotë dhe i saktë, duke krijuar një dëm ekonomik për llogari të APD-së dhe Buxhetit të Shtetit në **vlerën 147,541 lekë** (*Trajtuar më hollësisht në faqet 129-202, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 147,541 lekë** nga shoqëria “X.11” sh.p.k për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës me objekt “Zbatim-Furnizim Vendorsje e kalunave në kalatat 1,2,3 dhe 4”, viti 2015, vlerë e cila për Autoritetin Portual Durrës dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik**.

Brenda datës 31.12.2016

6. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga shoqëria “X.13” sh.a, me objekt “Blerje vajra dhe lubrifikante”, viti 2015, u konstatua se dokumentacioni teknik i furnizimit me vajra dhe lubrifikante nuk është i plotë dhe i saktë, duke krijuar një dëm ekonomik për llogari të APD-së dhe Buxhetit të Shtetit në **vlerën 4,419,900 lekë** (*Trajtuar më hollësisht në faqet 129-202, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **4,419,900 lekë**, nga shoqëria "X.13" sh.a, për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës me objekt "Blerje vajra dhe lubrifikante", viti 2015, n.q.s nuk paraqitet në APD fletë analizë për secilin nga artikujt lubrifikant të furnizuar, lëshuar nga një institucion i akredituar në Shqipëri ose laboratorë të tjerë ndërkombëtarë, që të konfirmohet që këto vajra dhe lubrifikante janë të njëjta me atë të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën shoqëria "X.13" sh.a, ka fituar tenderin dhe është likuiduar. Vlera **4,419,900 lekë** për Autoritetin Portual Durrës dhe Buxhetin e Shtetit, përbën **dëm ekonomik** dhe duhet të dëmshpërblehet nga Shoqëria "X.13" sh.a.

Brenda datës 31.12.2016

7. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Blerje vajra dhe lubrifikante", viti 2015, u konstatua se janë rritur në mënyrë të paargumentuar dhe të pabazuar ligjërisht shpenzimet në fazën e përllogaritjes së fondit limit dhe ofertës së kësaj shoqërie të paraqitur në tender në vlerën **352,500 lekë**, vlerë e cila ka rënduar padrejtësisht koston e investimit (*Trajtuar më hollësisht në faqet 129-202, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të shqyrtojë **vlerën 352,500 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit "Blerje vajra dhe lubrifikante", vlerë e cila ka dalë si rezultat i ofertës së paraqitur nga shoqëria "X.13" sh.a, në përllogaritjen e fondit limit dhe ofertën e kësaj shoqërie të paraqitur në tender, vlerë e cila ka rënduar padrejtësisht koston e investimit. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për shoqërinë Autoritetin Portual Durrës dhe Buxhetin e Shtetit, përbën **dëm ekonomik**.

Brenda datës 31.12.2016

8. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt "Blerje autovetura", viti 2014, me shoqërinë "X.14" shpk, u konstatua se dokumentacioni shoqëruar i autoveturave si: Çertifikatë origjine, test raporti i fabrikës, certifikatën e siguracionit, certifikata e garancisë, dokumentin e transportit (CMR) etj me **vlerë 8,754,350 lekë**, nuk është i plotë dhe i saktë.

Veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10,489 datë 15.12.2011 "Për trajtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore", neni 3 pika 11, 12, 16, 17, 18, 21 neni 8, neni 9 dhe neni 10, si dhe VKM nr. 369, datë 27.3.2008 Për miratimin e rregullit teknik "Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve elektrike, të projektuara për përdorim brenda disa kufijve të tensionit".

Grupi i Auditimit referuar praktikës dokumentare të vënë në dispozicion, e cila rezultoi e pasaktë dhe me mangësi, nuk mund që të konfirmojë që këto autovetura janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën shoqëria "X.14" shpk, ka fituar tenderin dhe është likuiduar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 129-202, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një Grupi teknik me specialistë të fushës (përfashtuar ata që kanë marrë pjesë në kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të autoveturave), i cili të kryejë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojë autenticitetin e autoveturave, që të konfirmohet që këto autovetura janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), si dhe të verifikojë gjendjen e tyre teknike pas vendosjes në punë, nëse kanë qenë ose jo problematike.

Në rast se nga procesi i verifikimit rezulton se autoveturat e furnizuara nga shoqëria "X.14" shpk, nuk janë autentike, nuk janë konform specifikimeve teknike të përcaktuar në

procedurën e tenderimit, dhe gjendja e tyre teknike pas vendosjes në punë ka qenë problematike (defekte etj), **konsiderohet dëm ekonomik** dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit **arkëtimi i vlerës 8,754,350** nga shoqëria “X.14” shpk. Kjo çështje do të verifikohet nga KLSH-ja, në vijimësi në programet e zbatimit të rekomandimeve.

Brenda datës 31.12.2016

9. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt “Blerje litarë çeliku”, viti 2014, me shoqërinë “X.15”, u konstatua se dokumentacioni shoqërues i litarëve të çelikut si: test raporti i fabrikës me **vlerë 68,988 EUR**, nuk është i plotë dhe i saktë.

Veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10,489 datë 15.12.2011 “Për trajtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore”, neni 3 pika 11, 12, 16, 17, 18, 21 neni 8, neni 9 dhe neni 10, si dhe VKM nr. 369, datë 27.3.2008 Për miratimin e rregullit teknik "Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve elektrike, të projektuara për përdorim brenda disa kufijve të tensionit".

Grupi i Auditimit referuar praktikës dokumentare të vënë në dispozicion, e cila rezultoi e pasaktë dhe me mangësi, nuk mund që të konfirmojë që litarët e çelikut janë të njëjtë me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën shoqëria “X.15”, ka fituar tenderin dhe është likuiduar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 129-202, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një Grupi teknik me specialistë të fushës (përfshijtur ata që kanë marrë pjesë në kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të litarëve të çelikut), i cili të kryejë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojë autenticitetin e litarëve të çelikut, që të konfirmohet që këto litarë çeliku janë të njëjtë me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), si dhe të verifikojë gjendjen e tyre teknike pas vendosjes në punë, nëse kanë qenë ose jo problematike.

Në rast se nga procesi i verifikimit rezulton se litarët e çelikut të furnizuar nga shoqëria “X.15”, nuk janë autentik, nuk janë konform specifikimeve teknike të përcaktuar në procedurën e tenderimit, dhe gjendja e tyre teknike pas vendosjes në punë ka qenë problematike (defekte etj), **konsiderohet dëm ekonomik** dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit **arkëtimi i vlerës 68,988 EUR** nga shoqëria “X.15”. Kjo çështje do të verifikohet nga KLSH-ja, në vijimësi në programet e zbatimit të rekomandimeve.

Brenda datës 31.12.2016

10. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt “Blerje pjesë këmbimi elektrike”, viti 2014, me shoqërinë “X.16” shpk, u konstatua se dokumentacioni shoqërues i pjesëve të këmbimit elektrike si: test raporti i fabrikës, certifikatën e siguracionit, certifikata e garancisë, dokumentin e transportit (CMR) etj, me **vlerë 15,111,792 lekë**, nuk është i plotë dhe i saktë.

Veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10,489 datë 15.12.2011 “Për trajtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore”, neni 3 pika 11, 12, 16, 17, 18, 21 neni 8, neni 9 dhe neni 10, si dhe VKM nr. 369, datë 27.3.2008 Për miratimin e rregullit teknik "Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve elektrike, të projektuara për përdorim brenda disa kufijve të tensionit".

Grupi i Auditimit referuar praktikës dokumentare të vënë në dispozicion, e cila rezultoi e pasaktë dhe me mangësi, nuk mund që të konfirmojë që pjesët e këmbimit janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën shoqëria “X.16” shpk, ka fituar

tenderin dhe është likuiduar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 129-202, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një Grupi teknik me specialistë të fushës (përfshirë ata që kanë marrë pjesë në kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të pjesëve të këmbimit), i cili të kryejë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojë autenticitetin e pjesëve të këmbimit, që të konfirmohet që këto pjesë këmbimi janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), si dhe të verifikojë gjendjen e tyre teknike pas vendosjes në punë, nëse kanë qenë ose jo problematike.

Në rast se nga procesi i verifikimit rezulton se pjesët e këmbimit të furnizuar nga shoqëria "X.16" shpk, nuk janë autentike, nuk janë konform specifikimeve teknike të përcaktuar në procedurën e tenderimit, dhe gjendja e tyre teknike pas vendosjes në punë ka qenë problematike (defekte etj), **konsiderohet dëm ekonomik** dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit **arkëtimi i vlerës 15,111,792 lekë** nga shoqëria "X.16" shpk. Kjo çështje do të verifikohet nga KLSH-ja, në vijimësi në programet e zbatimit të rekomandimeve.

Brenda datës 31.12.2016

11. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se për periudhën 01.11.2013-31.01.2016, është paguar shtesa mbi pagë për diplomën 2 punonjësve të cilët nuk ishin pajisur me diplomë universitare, duke shkaktuar **dëm ekonomik** në vlerën **132,000 lekë**. Për periudhën 01.02.2016-30.04.2016, për 2 punonjës është paguar **më pak** shtesa e pagës për diplomën **në vlerën 15,000 lekë**, ndërsa për 8 punonjës është paguar më shumë shtesa e pagës për diplomën duke shkaktuar **dëm ekonomik në vlerën 120,000 lekë**. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 524, datë 16.08.2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 545, datë 11.8.2011 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të Nëpunësve civilë/nëpunësve, Zëvendësministrit dhe Nëpunësve të Kabineteve në Kryeministri, aparatet e Ministrive të Linjës, Administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, Institucionet në varësi të Ministrave të linjës dhe Administratën e Prefektit", të ndryshuar" (*Trajtuar më hollësisht në faqet 67-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **252,000 lekë**, për përfitim të pa drejtë shpërblimi page për arsye se janë pa diplomat përkatëse dhe kanë përfituar shtesat e pagës për diplomën, nga: A.O në vlerën 138,000 lekë, A.M në vlerën 78,000 lekë, M.M në vlerën 12,000 lekë, R.K në vlerën 12,000 lekë, A.Ç në vlerën 9,000 lekë dhe H.V në vlerën 3,000 lekë, si dhe të korrigjohet dhe të kthehet shtesa e pagesës në vlerë **15,000 lekë** për S.K për vlerën 3,000 lekë dhe për S.M për vlerën 12,000 lekë.

Brenda datës 30.11.2016

12. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se në 10 raste në vlerën **2,743,750 lekë** janë përfituar sponsorizime, për të cilat nuk vërtetohet plotësisht kryerja e këtij shpenzimi, pasi një pjesë e dokumentacionit justifikues bazë është me mangësi. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe udhëzimin e MF nr. 24 datë 2.09.2008 "Për procedurat tatimore në RSH" të ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 75-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **2,743,750 lekë, nga 10 subjektet përfituese** të sponsorizimeve, pasi nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit, nuk vërtetohet plotësisht kryerja e këtij shpenzimi, pasi një pjesë e dokumentacionit justifikues bazë është me mangësi. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe udhëzimin e MF nr. 24 datë 2.09.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” të ndryshuar”. Në mënyrë të detajuar aneksi nr. 1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.11.2016

13. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 1653, datë 02.06.2016, me vlerë 2,400,000 lekë me objekt “Auditimi i Pasqyrave Financiare për vitet 2015-2016, u konstatua se nuk është respektuar afati i realizimit të kësaj kontrate. Konkretisht raporti i auditimit të pasqyrave financiare të vitit ushtrimor 2016, është protokolluar në APD me nr. 2099 prot., datë 29.07.2016. Raporti i auditimit është dorëzuar 12 ditë me vonesë, në kundërshtim me nenin 19 të kontratës, ku parashikohet 45 ditë nga nënshkrimi i saj. Deri më datë 12.08.2016, nga shoqëria X.17 nuk janë paraqitur rekomandimet e auditimit me anë të Letrës së Menaxhimit, në kundërshtim me nenin 1, pika 1.3.2 “*Letra e Menaxhimit*”.

Për pasojë, në zbatim të nenit 20.1 të kontratës, APD duhet ti kërkonte likuidimin e dëmeve për dorëzim të vonuar, në vlerën 104,000 lekë (26 ditë * 1,000,000 lekë * 4/1000), **vlerë e cila për APD dhe Buxhetin e Shtetit përbën dëm ekonomik** (Trajtuar më hollësisht në faqet 129-202, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **104,000 lekë** nga operatori ekonomik “X.17” SHPK, për dorëzimin me vonesë të raportit të auditimit të pasqyrave financiare të vitit ushtrimor 2015 dhe letrës së menaxhimit, në zbatim të kontratës nr. 1653, datë 02.06.2016.

Brenda datës 30.11.2016

14. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Rehabilitimi i segmentit rrugor: Hyrja nr. 2 - Terminali i trageteve”, u konstatua se shpallja fitues e operatorit ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratës, është kryer **në mënyrë të padrejtë**, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurës administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 115-120, **duke krijuar një dëm ekonomik në vlerën 921,360 lekë** (Trajtuar më hollësisht në faqet 129-202, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të shqyrtojë vlerën **921,360 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit me objekt “Rehabilitimi i segmentit rrugor: Hyrja nr. 2 - Terminali i trageteve”, vlerë e cila ka dalë si rezultat i diferencës së ofertës së shpallur fituese OE “X.18” SHPK me vlerë 11,010,800 lekë, me ofertën e OE “X.19” SHPK me vlerë 10,243,000 lekë, e cila është skualifikuar pa të drejtë. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për Autoritetin Portual Durrës dhe Buxhetin e Shtetit përbën **dëm ekonomik**.

Brenda datës 30.11.2016

15. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Sistemimi i pjesës pranë rrethimit TIR në krah të rrugës- Hyrja 4- Terminali i trageteve”, u konstatua se shpallja fitues e operatorit

ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratës, është kryer ***në mënyrë të padrejtë***, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurës administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 115-120, **duke krijuar një dëm ekonomik në vlerën 867,353 lekë** (Trajtuar më hollësisht në faqet 64-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të shqyrtojë vlerën **867,353 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit me objekt “Sistemimi i pjesës pranë rrethimit TIR në krah të rrugës- Hyrja 4- Terminali i trageteve”, vlerë e cila ka dalë si rezultat i diferencës së ofertës së shpallur fituese “X.11” SHPK me vlerë 11,099,640 lekë, me ofertën e bashkimit të “X.19 SHPK & X.20 SHPK” me vlerë 10,376,846 lekë, e cila është skualifikuar pa të drejtë. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për Autoritetin Portual Durrës dhe Buxhetin e Shtetit përbën **dëm ekonomik**.

Brenda datës 30.11.2016

16. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga “X.19” sh.p.k me objekt “Prishja e godinave të ish-Albtelecom dhe ish-Rezervave të Shtetit”, viti 2015, u konstatua se dokumentacioni teknik i zbatimit dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit nuk është i plotë dhe i saktë, duke krijuar një dëm ekonomik për llogari të APD-së dhe Buxhetit të Shtetit në **vlerën 178,440 lekë** (Trajtuar më hollësisht në faqet 129-202, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **178,440 lekë** nga operatori ekonomik “X.19” SHPK, vlerë e cila ka rënduar padrejtësisht koston e investimit në zërin “Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri në 10 km”, si dhe nuk provohet (vërtetohet) kryerje e këtij shpenzimi me dokumentacion përkatës.

Brenda datës 31.12.2016

17. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Shtesë kontrate blerje uniforma dhe veshje pune për APD” viti 2015, u konstatua se për 10 artikuj çmimi i kontraktuar është më i lartë se çmimi i kontratës fillestare nr. 290, datë 29.01.2015 “Blerje uniforma dhe veshje pune për APD në vlerën **615,360 lekë**, vlerë e cila ka rënduar padrejtësisht koston e mallrave (Trajtuar më hollësisht në faqet 129-202, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të shqyrtojë vlerën **615,360 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit me objekt “Shtesë kontrate blerje uniforma dhe veshje pune për APD”, vlerë e cila ka rënduar padrejtësisht koston e mallrave, pasi për 10 artikuj çmimi i kontraktuar është më i lartë se çmimi i kontratës fillestare nr. 290, datë 29.01.2015 “Blerje uniforma dhe veshje pune për APD”. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për Autoritetin Portual Durrës dhe Buxhetin e Shtetit përbën **dëm ekonomik**.

Brenda datës 31.10.2016

18. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Zëvendësimi i kangjellave në Terminalin Perëndimor”, u konstatua se shpallja fitues e operatorit ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratës, është kryer ***në mënyrë të padrejtë***, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurës administrative të Republikës së Shqipërisë”, i

ndryshuar, nenet 115-120, **duke krijuar një dëm ekonomik në vlerën 120,000 lekë** (Trajtuar më hollësisht në faqet 129-202, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të shqyrtojë vlerën **120,000 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit me objekt “Zëvendësimi i kangjellave në Terminalin Perëndimor”, vlerë e cila ka dalë si rezultat i diferencës së ofertës së shpallur fituese “X.21” SHPK me vlerë 3,700,000 lekë, me ofertën e “X.22” SHPK me vlerë 3,600,000 lekë, e cila është skualifikuar pa të drejtë. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për Autoritetin Portual Durrës dhe Buxhetin e Shtetit përbën **dëm ekonomik**.

Brenda datës 31.10.2016

19. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 514, datë 18.02.2015 me objekt “Konsulencë për laboratorin mjedisor”, viti 2015, u konstatua se janë rritur në mënyrë të paargumentuar dhe të pabazuar ligjërisht shpenzimet në vlerën **648,000 lekë**, pasi në preventivin e këtij shërbimi është vendosur zëri “Trajnim për përdorimin e pajisjeve të laboratorit”, zë i cili është prokuruar njëherë me kontratën nr. 1748, datë 12.07.2011, me objekt “Sistemi elektronik dhe pajisje për monitorimin ambiental”, vlerë e cila ka rënduar padrejtësisht koston e shërbimeve (Trajtuar më hollësisht në faqet 129-202, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të shqyrtojë vlerën **648,000 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës nr. 514, datë 18.02.2015, me objekt “Konsulencë për laboratorin mjedisor”, vlerë e cila ka rënduar padrejtësisht koston e shërbimeve, pasi në preventivin e këtij shërbimi është vendosur zëri “Trajnim për përdorimin e pajisjeve të laboratorit”, zë i cili është prokuruar njëherë me kontratën nr. 1748, datë 12.07.2011, me objekt “Sistemi elektronik dhe pajisje për monitorimin ambiental”, me vlerë 8,218,380 lekë pa tvsh. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për Autoritetin Portual Durrës dhe Buxhetin e Shtetit përbën **dëm ekonomik**.

Brenda datës 31.10.2016

20. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 514, datë 18.02.2015 me objekt “Konsulencë për laboratorin mjedisor”, viti 2015, u konstatua se janë rritur në mënyrë të paargumentuar dhe të pabazuar ligjërisht shpenzimet në vlerën **1,704,000 lekë**, pasi nga verifikimi fizik i datës 22.07.2015, u konstatua se dokumentacioni i hartuar nga kontraktori “X.23” SHPK, nuk përdoret nga laboratorit i APD, vlerë e cila ka rënduar padrejtësisht koston e shërbimeve (Trajtuar më hollësisht në faqet 129-202, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të shqyrtojë vlerën **1,704,000 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës nr. 514, datë 18.02.2015, me objekt “Konsulencë për laboratorin mjedisor”, për arsye se nga verifikimi fizik i datës 22.07.2015, u konstatua se dokumentacioni i hartuar nga kontraktori “X.23” SHPK, nuk përdoret nga laboratorit i APD. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për Autoritetin Portual Durrës dhe Buxhetin e Shtetit përbën **dëm ekonomik**.

Brenda datës 31.10.2016

21. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Zbatim-ndërtim i bazamentit të sillosave të drithit dhe spostimin e tyre në sheshin pas kalatës 2”, u konstatua se shpallja fitues e operatorit ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratës, është kryer **në mënyrë të padrejtë**, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, VKM nr. 914 datë

29.12.2014 "Rregullat e Prokurimit", Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i procedurës administrative të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, nenet 115-120, **duke krijuar një dëm ekonomik në vlerën 59,222 lekë** (Trajtuar më hollësisht në faqet 129-202, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të shqyrtojë vlerën **59,222 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit me objekt "Zbatim-ndërtim i bazamentit të sillosave të drithit dhe spostimin e tyre në sheshin pas kalatës 2", vlerë e cila ka dalë si rezultat i diferencës së ofertës së shpallur fituese "X.24" SHPK me vlerë 14,594,000 lekë, me ofertën e bashkimit të "X.25 & X.26" me vlerë 14,544,648 lekë, e cila është skualifikuar pa të drejtë. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për Autoritetin Portual Durrës dhe Buxhetin e Shtetit përbën **dëm ekonomik**.

Brenda datës 31.10.2016

22. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi ka rezultuar se me urdhër shpenzimin e datës 24.07.2014 është paguar nëpërmjet BKT vlera prej 2,898,000 lekë në favor të B.Dh, sipas kërkesës së tij drejtuar APD me nr. 1839 prot., datë 25.06.14, për zbatim të vendimit të Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Durrës me nr. 2091 datë 30.07.2013, i cili është lënë në fuqi me vendimin nr. 1263, datë 26.03.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Në këtë praktikë rezultoi se B.Dh i është paguar përveç të tjerave dhe e gjithë periudha prej 12 muaj si shpërblim për shkëputjen nga puna në një kohë që ky punonjës referuar largimit dhe ri emërimit në detyrë ka rezultuar vetëm me 4.5 muaj shkëputje nga puna (theksojmë se është punësuar në të njëjtin vend pune dhe nivel page). Pra shuma nga 12 muaj duhej të konvertohej në 4.55 muaj. Si pasojë APD dhe Buxhetit të Shtetit i është krijuar një **dëm ekonomik në vlerën 1,199,550 lekë** (Trajtuar më hollësisht në faqet 75-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i vlerës **1,199,550 lekë** nga B.Dh, vlerë e cila përfituar padrejtësisht nga zbatimi i vendimit të Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Durrës me nr. 2091 datë 30.07.2013, i cili është lënë në fuqi me Vendimin nr. 1263, datë 26.03.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë (për zgjidhje të pa arsyeshme kontratës së punës).

Brenda datës 31.10.2016

23. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi ka rezultuar se me urdhër shpenzimin e datës 12.09.2014 është paguar nëpërmjet BKT shuma prej 14,279 Euro shoqërisë "X.27" sh.p.k, në zbatim të vendimit të KD të APD nr. 16, datë 23.05.2014 "Mbi pranimin e pjesshëm të kërkesës së shoqërisë "X.27" sh.p.k. Vendimmarrja e Këshillit Drejtues referuar argumenteve të dhëna dhe dokumentacionit të paraqitur dhe akteve në fuqi (udhëzimi MF nr. 31, datë 31.09.2010 dhe Vendimi i Këshillit Drejtues nr. 30, datë 15.12.2011 "Mbi faljen e detyrimeve të lindura nga aplikimi i normës së interesit", nuk ka mbështetje dokumentare dhe ligjore, për pasojë vlera **14,279 Euro**, është përfituar padrejtësisht nga shoqëria "X.27" (Trajtuar më hollësisht në faqet 75-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **14,279 EUR** nga shoqëria "X.27" sh.p.k, pasi ka përfituar padrejtësisht nga falja e kamatëvonesave me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 16, datë 23.05.2014.

Brenda datës 31.12.2016

24. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se në 3 raste për vlerën **384 Euro** janë përfituar padrejtësisht shpenzime udhëtim e dieta jashtë vendit, në kundërshtim me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin e punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 75-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Të kërkohej në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i vlerës **në vlerën 384 Euro**, vlerë e cila është përfituar padrejtësisht për shpenzime udhëtim e dieta jashtë vendit. *Në mënyrë të detajuar aneksi nr. 1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Brenda datës 31.12.2016

25. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se shoqëria X.5 nuk zbaton kontratën Koncesionare “Për dhënien me koncesion Menaxhimin, Operimin, Mirëmbajtjen dhe Përmirësimin Teknik të Terminalit Lindor në Portin e Durrësit, të nënshkruar në datën 06 Maj 2013, midis Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit dhe X.5. Konkretisht përsa i përket tarifës për kontratat e lidhura nga koncensionari X.5 për shesh përdorimi, depozitimi, dhe truall i lirë, të cilat nuk pasqyrohen, as për çdo ditë dhe as për çdo turn, por dorëzohen nga koncensionari “X.5” në mënyrë të njëanshme tek APD, në fund të muajit, kjo në kundërshtim me pikën e, të protokollit të dorëzimit, me nr 1810, datë 12.07.2013 “Protokolli dorëzimit dhe marrjes në dorëzim të Terminalit Lindor në Portin e Durrësit”, si dhe në kundërshtim me pikën 6, “Tarifat e dhënies me qira”, pika 6.1 “Tarifat për dhënien me qira të shesheve” të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Punëve Publike me nr 581/1, datë 06.02.2013 ”Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve në APD”, dhe me pikën 2, të “Kontratës mbi dhënien në shfrytëzim të sheshit të përdorimit duke krijuar një dëm ekonomik për APD dhe Buxhetin e Shtetit në 1,165,868 lekë (*Trajtuar më hollësisht në faqet 210-237, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të **prezantohet** në organet drejtuese vlera **1,165,868 lekë**, që ka të bëjë me llogaritjen e tarifës për kontratat e lidhura për shesh përdorimi nga koncensionari X.5 (përdorimi, depozitimi, truall i lirë), të cilat nuk pasqyrohen, as për çdo ditë dhe as për çdo turn, por dorëzohen nga koncensionari “X.5” në mënyrë të njëanshme tek APD, në fund të muajit, kjo në kundërshtim me pikën e, të protokollit të dorëzimit, me nr 1810, datë 12.07.2013 “Protokolli dorëzimit dhe marrjes në dorëzim të Terminalit Lindor në Portin e Durrësit”, si dhe në kundërshtim me pikën 6, “Tarifat e dhënies me qira”, pika 6.1 “Tarifat për dhënien me qira të shesheve” të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Punëve Publike me nr 581/1, datë 06.02.2013 ”Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve në APD”, dhe me pikën 2, të “Kontratës mbi dhënien në shfrytëzim të sheshit të përdorimit”. Vlera **1,165,868 lekë** përbën **dëm ekonomik** për APD dhe Buxhetin e Shtetit.

Brenda datës 30.11.2016

26. Gjetje nga auditimi:

Me kërkesë për transfertë bankare është likuiduar në vlerën 48,000 EUR për llogari të “X.28” nëpërmjet Bankës, pa dokumentacion justifikues (vërtetues) dhe pa procedurë prokurimi. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 26 dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 35, gërma a, si dhe pika 36, Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 6 dhe ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 7, si dhe VKM nr. 1195, datë 05.08.2008 “Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkëprodhimin e programeve a reklamave për transmetim nga operatorët radiotelevizivë ose botim në median e shkruar, dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore”, Kreu II “Procedura

për realizimin e një programi, të një reklame apo spoti” *Trajtuar më hollësisht në faqet 75-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të shqyrtojë vlerën **48,000 EUR**. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në likuidimin e “X.28” për shërbim publik nëpërmjet botimit në median e shkruar pa dokumentacion justifikues (vërtetues), viti 2015. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për APD dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik.**

Brenda datës 30.11.2016

27. Gjetje nga auditimi:

Në dy raste është likuiduar personi fizik F.L në vlerën **198,500 lekë**, për riparimin e makinave me targë dhe me targë, pa procedurë prokurimi duke e quajtur si rast emergjencë. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe të udhëzimeve të APP për rastet e shërbimeve emergjente (*Trajtuar më hollësisht në faqet 75-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Për sa më sipër rekomandojmë:

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të shqyrtojë vlerën **198,500 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në likuidimin Personit Fizik F. L për riparimin e makinave me targë dhe me targë, pa procedurë prokurimi. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për APD dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik.**

Brenda datës 30.11.2016

28. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se në përpunimin e anijeve, peshimet dhe faturimet u janë bërë Agjencive speditionare pa hartuar kontrata respektive mes palëve (APD dhe agjencive), duke përcaktuar detyrimet e ndërsjellta. Kjo ka sjellë si pasojë mos likuidime të faturimeve në masën 44 %, si dhe interesa nga moslikuidimi në kohë në vlerën **1,095,437 lekë** (*Trajtuar më hollësisht në faqet 207-210, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Për sa më sipër rekomandojmë

-Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të shqyrtojë vlerën **1,095,437 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në shërbimet operacionale. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për APD dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik.**

Brenda datës 30.11.2016

29. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se Autoriteti Portual Durrës ka likuiduar për llogari të Projektit BEI-BERZH dhe shoqërisë “X.29” shpk për kalatën 7 dhe 8 vlerën **1,168,120.51 EUR**. Për likuidimin e kësaj vlere janë lidhur aktmarrëveshje si poshtë vijon:

-Aktmarrëveshja nr. 1576 prot, datë 10.06.2013 (APD) dhe nr. 574 prot, datë 10.06.2013, firmosur nga E. N për APD dhe nga E. H për Njësinë e Zbatimit të Projektit, për faturën nr, 38, datë 31.05.2012, në vlerën 371,237 EUR.

-Aktmarrëveshja nr. 1857 prot, datë 10.06.2015 (APD) dhe nr. 834 prot, datë 10.06.2015, për APD firmosur nga G. Sh dhe për Njësinë e Zbatimit të Projektit nga Xh. T, për faturën nr. 39, datë 31.05.2012, në vlerën 726,073 EUR.

Të dyja aktmarrëveshjet e sipër cituara janë lidhur në kundërshtim me:

-Ligjin nr. 9691, datë 08.03.2007 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve

(BEI) për financimin me kredi të Projektit “Ndërtimi i Terminalit të trageteve dhe shesheve përreth në Portin e Durrësit”.

-Ligjin nr. 9758, datë 21.06.2007 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për marrëveshjen e kredisë ndërmjet Autoritetit Portual Durrës dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për financimin e projektit “Ndërtimi i Terminalit të trageteve dhe i shesheve përreth në Portin e Durrësit”.

-Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 775, datë 24.09.2010 “Për administrimin e financimeve të huaja në Republikën e Shqipërisë”.

-VKM nr. 692, datë 10. 11.2005 “Për miratimin e strategjisë së ripunuar “Konsolidimi i një sistemi planifikimi të integruar në Shqipëri”, pika 6.

-Rregulloren e brendshme të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 69 datë 15.10.2012 të Këshillit Drejtues të APD, pika 4 Këshilli drejtues, nënpika 7/i.

-VKM nr. 596, datë 10.9.2004 “Për miratimin e statutit të Autoritetit Portual Durrës dhe për riorganizimin e tij”, neni 9.

-Udhëzimin e MF nr. 36, datë 10.08. 2009 “Për hartimin e regjistrit të borxhit shtetëror dhe garancive shtetërore të huasë”, neni 2.

-Udhëzimin e MF nr. 22, datë 05.10.2011 “Për publikimin e të dhënave të borxhit të qeverisjes së përgjithshme dhe hartimin e raportit të tij” dhe neni 7, pikat 5 dhe 6.

Për veç sa përshkruar mësipër referuar shkresës së Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës nr. 7541 prot, datë 12.12.2014, protokolluar në APD nr. 689 prot, datë 11.12.2014, Raporti i Ekspertit teknik, i njeh kontraktorit vlerën 813,860.58 EUR, e përbërë nga;

-Punime shtesë në vlerën 149,178.15 EUR.

-Rregullime në çmim në vlerën -252,214.21 EUR.

Paraja e mbajtur 829,109.12 EUR.

-Vonesa në pagesa 79.131.52 EUR

-50 % e kostos së DAP 8,656 EUR

Diferenca: 1,168,120 EUR të likuiduara PIU-t dhe shoqërisë “X.29” shpk (respektivisht në vlerat 1,097,310 dhe 70,810.40) - 813,860 EUR që ka njohur eksperti= 354,260.51 EUR. Kjo vlerë përfshin brenda dhe vlerën 87,787 EUR (79.131.52 + 8,656) që janë penalitet të bankës për mos paraqitjen në kohë të dokumentacionit dhe tërheqjen e fondeve të akorduara, në total dëmi shkon në vlerën 442,047 EUR (354,260+ 87,787=442,047).

Përpos kësaj, kësaj vlerë i shtohet dhe interesat që APD, ka humbur nga kalimi i vlerave për llogari të PIUT në shumën 44,330.80 EUR. Në total vlera 486,377 EUR përbën dëm ekonomik për APD dhe Buxhetin e Shtetit. Ka pasur mosmarrëveshje mes Kontraktorit X.29 Sh.p.k dhe Supervizorit X.30 & X.31, në përfundim të punimeve, mosmarrëveshje të cilat janë gjykuar në Bordin e Gjykimit të Mosmarrëveshjeve (Dispute Adjudication Board) parashikuar në kushtet e përgjithshme dhe specifike të Kontratës, nga ku rezultoi sipas vendimit të Arbitrit J. P, se kontraktorit X.29 Sh.p.k i detyrohen një shumë 3,610,757 EUR. Çështja aktualisht është në arbitrazh ndërkombëtar (International Chamber of Commerce) në Paris. Avokatura e Lartë e Shtetit po përfaqëson ligjërisht MTI në këtë çështje arbitrazhi (Trajtuar më hollësisht në faqet 75-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë

-Këshilli Drejtues të shqyrtojë vlerën **486,377 EUR**. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në likuidimin nga APD të shoqërisë “X.29” shpk për llogari Projektit BEI-BERZH për kalatën 7 dhe 8. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për APD dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik**.

Brenda datës 31.12.2016

30. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 3048, datë 29.10.2014, me objekt “Blerje Motoskafi (Anije Patrullimi)”, viti 2014, u konstatua se janë rritur në mënyrë të paargumentuar dhe të pabazuar ligjërisht shpenzimet, pasi brenda garancisë së defekteve është shpenzuar nga APD vlera 708,206 lekë për riparimin e defekteve të ndryshme, duke rënduar në këtë mënyrë padrejtësisht vlerën e investimit (*Trajtuar më hollësisht në faqet 129-202, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë

-Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të shqyrtojë vlerën **708,206 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit “Blerje Motoskafi (Anije Patrullimi), viti 2015. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për APD dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik**.

Brenda datës 31.12.2016

31. Gjetje nga auditimi:

-Autoriteti Portual Durrës në një rast, në tejkallim të kompetencave (mbi 200 m²) i ka dhënë me qira operatorit “X.32”, shesh të hapur për shërbime portuale ngarkim shkarkimi, nëpërmjet copëtimit të sipërfaqeve të shesheve, **dhe pa procedurë prokurimi**, në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 5.2.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, si dhe i ka lejuar operatorit “X.32”, të përdorë një sipërfaqe prej 793 m², pa kontraktim dhe pa derdhur asnjë detyrim për APD dhe Buxhetin e Shtetit, **çka ka shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 1,052,350 lekë** (*Trajtuar më hollësisht në faqet 207-210, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **1,052,350 lekë** nga Shoqëria “X.32”, për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratave për marrje me qira të shesheve për shërbime portuale dhe ngarkim shkarkimi, vlerë e cila për Autoritetin Portual Durrës dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik**.

Brenda datës 31.12.2016

32. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi, është shpenzuar karburant për mjetet e APD në sasinë 43,285 litra me vlerë 6,371,325 lekë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit, nuk vërtetohet plotësisht kryerja e këtij shpenzimi, pasi një pjesë e dokumentacionit justifikues bazë është me mangësi. Konkretisht nuk ka fletë-udhëtime, urdhër pune, kartelat përkatëse të tyre, rakordime mujore dhe vjetore për sasinë e naftës së tërhequr nga magazina me harxhimin në fakt të sasisë së tërhequr për çdo drejtues mjeti etj. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, duke krijuar në këtë mënyrë për Autoritetin Portual Durrës dhe Buxhetin e Shtetit një **dëm ekonomik** në vlerën **6,371,325 lekë** (*Trajtuar më hollësisht në faqet 75-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë

-Këshilli Drejtues të shqyrtojë vlerën **6,371,325 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në shpenzimet për karburant për mjetet APD (për mjetet e administratës dhe FSPD), për të cilat nuk vërtetohet plotësisht kryerja e këtij shpenzimi, në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”.

Brenda datës 31.12.2016

33. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi mbi shpenzimet e karburantit, për periudhën 01.11.2013–30.04.2016 u konstatua se mjeti Autoambulancë, me targë, ka tërhequr sasinë e 3353 litrave naftë me vlerë 534,985 lekë. Kjo sasi karburanti nuk duhet të rëndonte shpenzimet e APD, pasi Terminali i trageteve i cili ka kaluar me koncesion kompanisë X.6. Për pasojë për këtë shërbim duhet të ishte bërë amendim i kontratës, ku ky shpenzim të likuidohet prej tyre, siç likuidohen shpenzimet e dritave, ujit etj. Gjithashtu për drejtuesin e mjetit T. H nga data e emërimit të tij në këtë pozicion datë 13.08.2014 e në vazhdim, kartelat mujore të mjetit me targë, janë firmosur nga kushëriri i tij drejtori i drejtorisë së mjedisit Sh. H, në kushtet e konfliktit faktik dhe të vazhdueshëm të interesit, si dhe pa asnjë dokument justifikues ose provues (fletë udhëtimi). Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, neni 3, pika 1 dhe pika 4, neni 4 “Fusha e zbatimit”, neni 5 “Interesat privatë”, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 75-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të shqyrtojë vlerën **534,985 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me shpenzimet e karburantit në sasinë 3,353 litra, me vlerë 534,985 lekë, të cilat nuk duhet të rëndonte shpenzimet e APD, pasi Terminali i trageteve i cili ka kaluar me koncesion kompanisë X.6. Për pasojë për këtë shërbim duhet të ishte bërë amendim i kontratës, ku ky shpenzim të likuidohet prej tyre, siç likuidohen shpenzimet e dritave, ujit etj. Gjithashtu për drejtuesin e mjetit T. H nga data e emërimit të tij në këtë pozicion datë 13.08.2014 e në vazhdim, kartelat mujore të mjetit me targë, janë firmosur nga kushëriri i tij drejtori i drejtorisë së mjedisit Sh. H, në kushtet e konfliktit faktik dhe të vazhdueshëm të interesit, si dhe pa asnjë dokument justifikues ose provues (fletë udhëtimi). Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, neni 3, pika 1 dhe pika 4, neni 4 “Fusha e zbatimit”, si dhe neni 5 “Interesat privatë”, Ligjin nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Udhëzimin të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për APD dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik**.

Brenda datës 31.12.2016

34. Gjetje nga auditimi:

Me vendim të Këshillit Drejtues nr. 12, datë 05.05.2015, Njësia e zbatimit të Projektit BEI-BERZH për kalatën 7 dhe 8, nga 3 punonjës është bërë me 8 punonjës që nga qershori 2015 deri në mars 2016, duke i krijuar një dëm ekonomik për APD dhe Buxhetin e Shtetit në **vlerën 3,048,293 lekë ose 22,410 EUR**. Në fakt kjo shtesë ka ardhur kur nga ky projekt ka ngelur vetëm faza e dytë, për të cilën është kryer tenderimi në vlerën 2,200,000 EUR. Theksojmë se në fazën e parë janë shpenzuar 25.83 milion EUR, me personel 3 veta punonjës të PIUT (*Trajtuar më hollësisht në faqet 75-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Këshilli Drejtues të rishqyrtojë vlerën **3,048,293 lekë ose 22,410 EUR**. Kjo vlerë ka të bëjë me shtesën e pa argumentuar të organikës të personelit të Njesisë së zbatimit të Projektit BEI-BERZH për kalatën 7 dhe 8, në 5 punonjës për periudhën Qershor 2015 deri në mars 2016, pasi kjo shtesë ka ardhur kur nga ky projekt ka ngelur vetëm faza e dytë, për të cilën është

kryer tenderimi në vlerën 2,200,000 EUR. Në fazën e parë janë shpenzuar 25.83 milion euro, me personel prej 3 punonjës të PIU, ndërsa për periudhën Qershor 2015 deri në mars 2016 është bërë 8 punonjës. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për APD dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik.**

Brenda datës 31.10.2016

35. Gjetje nga auditimi:

Me vendimin nr. 23, datë 01.06.2015 “Mbi rinovimin/nënshkrimin e kontratës me shoqërinë “X.7” SHPK”, Këshilli Drejtues i APD ka vendosur rinovimin e kontratës me objekt mbulimin e shërbimeve të ngarkim-shkarkimit të mallrave në port për një periudhë tjetër 10 vjeçare e vlefshme deri më datë 31.05.2025. Në lidhje me këtë rinovim kontrate, u konstatua se Shoqëria “X.7” SHPK, deri në datën e amendimit (zgjatjes) të kontratës nr. 363, datë 31.05.2005, **nuk ka kryer sigurimin e kësaj kontrate në vlerën 6,000,000 lekë**, në kundërshtim me pikën 9.1 dhe 9.2, të kësaj kontrate.

Theksojmë se Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit Publik” ka të shprehur në mënyrë eksplicite se “*Sigurimi i kontratës ka formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë veprimtari*”. Referuar këtij vendimi, APD duhet të vendosi në kushte të barabarta të gjitha shoqëritë stivadore që operojnë në aktivitetin e stivadorit (ose me depozitë apo garancie, të lëshuar nga një bankë, ose me garanci të lëshuar nga shoqëri sigurimi), dhe jo të veprojë në mënyrë të diferencuar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 210-237, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Këshilli Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të shqyrtojnë vlerën **6,000,000 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me sigurimin e amendimit të kontratës së shërbimeve të ngarkim/shkarkimit të mallrave në Portin e Durrësit me nr. 1959 prot., datë 19.06.2015 nga shoqëria “X.7” sh.p.k. Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit Publik” në të cilin në mënyrë eksplicite është cituar se “*Sigurimi i kontratës ka formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë veprimtari*”. Referuar këtij vendimi, APD duhet të vendosi në kushte të barabarta të gjitha shoqëritë stivadore që operojnë në aktivitetin e stivadorit (ose me depozitë apo garancie, të lëshuar nga një bankë, ose me garanci të lëshuar nga shoqëri sigurimi), dhe jo të veprojë në mënyrë të diferencuar. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për Autoritetin Portual Durrës dhe Buxhetin e Shtetit përbën **dëm ekonomik.**

Brenda datës 31.12.2016

B.2 TË ARDHURA TË MUNGUARA, SI DHE REALIZIM SHPENZIMESH JO NË PËRPUTHJE ME PARIMIN E EFICËNCËS MONETARE

1. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga shoqëria “X.11” sh.p.k me objekt “Ndërtimi i segmentit rrugor Hyrja nr. 4, Kalata Lindore”, viti 2015, u konstatua mosrespektim të afateve në zbatim të kësaj kontrate, duke krijuar një efekt financiar negativ për llogari të APD dhe Buxhetit të Shtetit në vlerën **26,095,589 lekë** (*Trajtuar më hollësisht në faqet 129-202, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të shqyrtojë vlerën **26,095,589 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me mosrespektimin e afateve nga shoqëria “X.11” sh.p.k të përcaktuara në kontratën “Ndërtimi i segmentit rrugor Hyrja nr. 4, Kalata Lindore”, të evidentohen përgjegjësitë dhe të

merren vendimi përkatës, vlerë e cila për APD dhe Buxhetin e Shtetit, përbën **efekt financiar negativ**.

Brenda datës 31.12.2016

2. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se Kompania “X.5” terminali lindor, nuk zbaton detyrimet e përcaktuara në kontratën koncesionare. Konkretisht:

Kontrata Koncesionare “Për dhënie me koncesion Menaxhimin, Operimin, Mirëmbajtjen dhe Përmirësimin Teknik të Terminalit Lindor në Portin e Durrësit, është nënshkruar në datën 06 Maj 2013, midis Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit dhe X.5. Periudha Koncesionare 35 vjet.

Brenda territorit të terminalit që prej fillimit të implementimit të kontratës koncesionare janë kryer dhe vazhdojnë të kryhen operacione të cilat nuk janë pjesë e Objektivit të saj, konkretisht:

a) Ajo e depozitimit të kontejnerëve bosh. Për këtë qëllim brenda në Terminal është krijuar dhe një shesh i posaçëm në krahun veri-lindor të Terminalit Lindor, i pa deklaruar në planimetrinë e territoreve paraqitur në kontratë, protokollin e dorëzimit apo në planin e investimit.

b) Proçeset e transportimit, nga terminali në terminal,

c) Ulje-ngritje e kontejnerëve,

d) Mbushje e kontejnerëve me mineral,

e) Përpunimi i pjesshëm i mineralit në territorin e Terminalit, qoftë ky me mënyrë artizanale apo edhe me makineri seleksionuese,

f) Procesi i peshimit të mjeteve mbi 7.5 ton.

(Proçese që janë konstatuar nga grupi i auditimit nga kamerat e monitorimit të drejtorisë së sigurisë portuale dhe nga korrespondenca e APD me këtë kompani dhe me Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës).

Proçese pune të cilat janë jashtë objektivit të kontratës dhe që të gjitha u faturohen nën kontraktorëve, në kundërshtim me nenin 2, pika 2.1 “Objekti i Koncesionit”, apo pika 2.3 “Përpunimi i ngarkesave të tjera”, nenin 8 të Kontratës “Çështje financiare dhe të pagesës”, ku tarifat e aplikuara nga ana e operatorit X.5 duhet të jenë në përputhje me librin e tarifave të APD-s dhe të ardhurat e përfituara, duhet të ndahen midis, Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, APD-s dhe X.5 sipas përqindjeve të përcaktuara (Fee Koncesionare).

Si pasojë e kryerjes së këtyre operacioneve X.5, ka realizuar vetëm për periudhën Korrik 2013- Mars 2015 afërsisht **527,059 ton** për mbushje kontejnerëve me krom ose minerale të tjera, për të cilat ka përfituar të ardhura financiare nga një aktivitet jashtë kontraktor. Nga informacionet e subjekteve për operacionet e mësipërme, X.5 faturon për çdo ton mesatarisht 5\$. Për pasojë për vlerën e volumeve të sipërpërmendura janë krijuar të ardhura të munguara në arkën e APD që afërsisht kanë vlerën e **290,000 \$** (për pjesën (11%) të kontratës që i takon APD)

-Marrja e informacioneve në lidhje me volumet e punës, të shoqëruar me formularët e miratuar, sipas përcaktimeve të bëra me shkresën prot. nr 1810, datë 18.07.2013, për çdo turn/ditë, pasqyrohet vetëm për treguesit e volumeve të punës për ngarkimin & shkarkimin e anijeve, *ndërsa për treguesit për zënien e shesheve* (përdorimi, depozitimi, truall i lirë), nuk pasqyrohen, as për çdo ditë dhe as për çdo turn, por dorëzohen nga koncesionari “X.5” në mënyrë të njëanshme tek APD, në fund të muajit, kjo në kundërshtim me pikën e, të protokollit të dorëzimit, me nr 1810, datë 12.07.2013 “Protokolli dorëzimit dhe marrjes në dorëzim të Terminalit Lindor në Portin e Durrësit”.

Llogaritja e tarifës për kontratat e lidhura për shesh përdorimi nga koncesionari X.5 është bërë në kundërshtim me pikën 6, “Tarifat e dhënies me qira”, pika 6.1” Tarifat për dhënie me qira të shesheve”, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit me nr 581/1, datë 06.02.2013 “Për përcaktimin e tarifave të

shërbimeve në APD”, dhe me pikën 2, të “Kontratës mbi dhënien në shfrytëzim të sheshit të përdorimit”, vlera prej **1,165,868 lekë** (si diferencë ndërmjet çmimit për ditë/sip/lekë * 11%), **përbën dëm ekonomik.**

-Detyrimi, bazuar në pikën 12.1.7 “Sistemi dhe rrjeti kompjuterik”, i kontratës Koncesionare nuk ka qenë i përcaktuar dhe detajuar saktë në funksionet e tij dhe grafikun kohor të implementimit, një gjë e tillë mungon edhe në ofertën teknike, procesverbalin e dorëzimit si edhe në planin e investimit të koncesionarit. Për pasojë, mungesa e shkëmbimit dhe marrjes së informacionit “on-line”, për çdo shërbim të kryer nga koncesionari tek Njësia e Monitorimit, është një prej arsyeve kryesore në shkeljet e referuara më sipër për monitorimin dhe deklarimin e volumeve, të kontratave nënkontraktore, të sipërfaqeve etj.

Ka paqartësi në kontratë, në lidhje me përfshirjen në mënyrë të pa drejtë dhe apriori të tarifës së hyrjes të mjeteve të transportit mbi 7.5 ton në tarifë shërbimi dhe ndarjes së saj sipas fee koncesionare. Kjo tarifë është vlerësuar dhe vjelë si tarifë e infrastrukturës edhe para “studimit përfundimtar të tarifave për Autoritetin Portual Durrës”, bërë nga X.33, dorëzuar Nr. 3257 Prot. Datë 09/10/2008, studim ku u mbështet ndërtimi i librit të tarifave të APD të vitit 2009 dhe në vazhdim dhe përcakton qartë këtë tarifë si tarifë të infrastrukturës dhe që vilet 100% nga APD.

Nga një llogaritje e përafërt vlera e humbur si pasojë e ndarjes apriori të kësaj tarife që prej fillimit të operimit të X.5 është në vlerën **18,564,038 lekë** ose **132,600 EUR.**

Të dhënat e trajtuara sa më sipër, janë deri në Mars 2015, mbas kësaj periudhe kjo kompani nuk ka dhënë asnjë informacion edhe pse informacioni është detyrim kontraktor.

-Ka shkelje të nenit 2.3 pika 2 dhe neni 12.1.1 pika f, të kontratës koncesionare në të cilin citohet se: “...koncesionari në zbatim të detyrimeve kontraktuale nuk duhet të imponojë në asnjë rast klientët për të përzgjedhur operatorët e tij të përpunimit”, si dhe moszbatim të Urdhrit të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Transporteve nr. 1164/3 prot, datë 23/03/2015 dhe nr. 2526/1 prot, datë 15/05/2015, në lidhje me ndalimin e operimit në Terminal të Stivadorëve të licensuar dhe me Kontratë shërbimi me APD. Këto shkelje kanë krijuar nga njëra anë konflikte tepër të mprehta midis koncesionarit dhe subjekteve të tjera private që operojnë në Portin e Durrësit, por edhe më gjerë sikurse janë agjencitë detare, kompanitë e transportit detar dhe subjektet që ato përfaqësojnë në marrëdhënie me koncesionarin X.5.

Sipas opinionit tonë: Marrëveshja e datës 6 Maj 2013 ka dëmtuar interesat e ligjshme të Shtetit dhe ka favorizuar kompaninë “X.5 (Terminali Lindor)”, çka përbën jo vetëm shkelje të rëndë të legjislacionit në fuqi, por është dhe një shprehje flagrante e mos zbatimit të ligjit (*Trajtuar më hollësisht në faqet 210-237, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të prezantohet në organet drejtuese:

-Vlera **290,000 USD** (për pjesën 11% të kontratës që i takon APD), që ka të bëjë me kryerjen e operacioneve të cilat nuk janë pjesë e objektit të Kontratës Koncesionare “Për dhënien me koncesion Menaxhimin, Operimin, Mirëmbajtjen dhe Përmirësimin Teknik të Terminalit Lindor në Portin e Durrësit është nënshkruar në datën 06 Maj 2013 midis Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit dhe Kompanisë “X.5”, konkretisht: Brenda në Terminal është krijuar dhe një shesh i posaçëm në krahun veri-lindor të Terminalit Lindor, i pa deklaruar në planimetrinë e territoreve paraqitur në kontratë, në protokollin e dorëzimit apo në planin e investimit.

a. Ajo e depozitimit të kontejnerëve bosh.

b. Proceset e transportimit, nga terminali në terminal:

c. Ulje-ngritje e kontejnerëve

ç. Mbushje e kontejnerëve me mineral,

d. Përpunimi i pjesshëm i mineralit në territorin e Terminalit, qofte ky me mënyrë artizanale apo edhe me makineri seleksionuese,

dh. Procesi i peshimit të mjeteve mbi 7.5 ton.

Vlera 290.000 USD përbën të ardhur të munguar për APD dhe Buxhetin e Shtetit.

-Vlera **132.600 EUR** që ka të bëjë me përfshirjen nga X.5 (Terminali Lindor), në mënyrë të pa drejtë dhe apriori të tarifës së hyrjes të mjeteve të transportit mbi 7.5 ton në tarifë shërbimi dhe ndarjes së saj sipas fee koncesionare. Kjo tarifë është vlerësuar dhe vjelë si tarifë e infrastrukturës edhe para “studimit përfundimtar të tarifave për Autoritetin Portual Durrës”, bërë nga X.33, dorëzuar Nr. 3257 Prot. Datë 09/10/2008, studim ku u mbështet ndërtimi i librit të tarifave të APD të vitit 2009 dhe në vazhdim dhe përcakton qartë këtë tarifë si tarifë të infrastrukturës dhe që vilet 100% nga APD. **Vlera 132,600 EUR përbën të ardhur të munguar për APD dhe Buxhetin e Shtetit.**

Sipas opinionit tonë, marrëveshja e datës 6 Maj 2013 ka dëmtuar interesat e ligjshme të Shtetit dhe ka favorizuar kompaninë “X.5 (terminali lindor)”, çka përbën jo vetëm shkelje të rëndë të legjislacionit në fuqi, por është dhe një shprehje flagrante e mos zbatimit të ligjit.

Për sa më sipër, Këshilli Drejtues, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, të marrin në analizë, të rishqyrtojnë dhe të rinegociojnë marrëveshjen me kompaninë koncesionare “X.5” (terminali lindor).

Brenda datës 30.11.2016

3. Gjetje nga auditimi:

Për periudhën objekt auditimi, në APD janë punësuar 190 punonjës dhe i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës 383 punonjësve. Për këtë periudhë, APD ka qenë palë në 63 procese gjyqësore, nga të cilët kanë përfunduar 34 prej tyre, ku në 18 raste APD ka humbur dhe në 16 raste APD e ka fituar procesin gjyqësor. Nga proceset gjyqësore të përfunduara për punonjësit të cilëve u është zgjidhur kontrata e punës në mënyrë të paarsyeshme, deri më datë 30.04.2016, APD ka paguar vlerën **17,882,656.44 lekë** për 17 punonjës, vlerë e cila për APD përbën **efekt financiar negativ** (Trajtuar më hollësisht në faqet 67-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Të shqyrtohet nga Këshilli Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv efekti financiar negativ i shkaktuar nga largimet e padrejta nga puna të punonjësve në vlerën **17,882,656.44 lekë**, si dhe të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës. Drejtoria e kontratave, çështjeve ligjore dhe koncesioneve e APD`së të marrë masa për ndjekjen e të gjitha çështjeve gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim minimizimin e pagesave për vendimet e gjykatës.

Brenda datës 31.12.2016

B.3. TË ARDHURA TË MUNGUARA NGA PROCESI I SHKARKIMIT, DEPOZITIMIT DHE EVADIMIT I TUBACIONEVE, MATERIALEVE TË NEVOJSHME, SI DHE MAKINERIVE TË PROJEKTIT TAP.

1. Gjetje nga auditimi:

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga APD, u konstatua se procesi i shkarkimit, depozitimit dhe evadimit i të tubacioneve, materialeve të nevojshme si dhe makinerive të projektit TAP, është realizuar nga kompania X.5 dhe jo nga Porti i Durrësit, i cili është i vetmi Autoritet Portual në Republikën e Shqipërisë, që gëzon të drejtën e dhënë nga ligji, për organizimin e shpërndarjen e ngarkesave (cargo) nëpër терминаlet e tij, sipas profilit të mallrave. APD disponon asetet e nevojshme infrastrukturore, makineritë dhe pajisjet për procesin e shkarkimit, depozitimit dhe evadimit të tubacioneve, materialeve të nevojshme, si dhe makinerive të projektit TAP, duke krijuar të ardhura të munguara për APD dhe Buxhetin e Shtetit, **në vlerën 71,168,800 lekë**. Konkretisht:

Shkarkimi i tubacioneve të TAP dhe të materialeve të tjera në funksion të tyre nga kompania X.5, është kryer pa licencën e stivadorit, në kundërshtim me pikën 3.2. 1 të kontratës koncesionare.

-Nga mos pajisja me licencën së stivadorit, kompania X.5 nuk i ka paguar tarifën e ushtrimit të një aktiviteti të tillë, *në vlerën 3,600,000 lekë, vlerë e cila është e Ardhur e munguar për APD dhe Buxhetin e Shtetit.*

-X.5, edhe pse e pa pajisur me licencën e stivadorit, ka vendosur monopol në këtë shërbim, pasi Porti i Durrësit nuk ka zhvilluar një procedurë për të përzgjedhur kompaninë stivadore, pra nuk ka patur një konkurrencë në këtë shërbim, në kundërshtim me ligjin nr. 9251, datë 08.07.2004 “Kodi detar i Republikës së Shqipërisë.

Kompania koncesionare X.5, edhe pse e pa pajisur me licencën e stivadorit, nuk ka lejuar shoqëritë e licencuara të ngarkim-shkarkimit (stivadorët) të kryejnë përpunimin e anijeve duke krijuar, në këtë mënyrë një monopol të paligjshëm në ofrimin e shërbimeve në Terminalin Lindor dhe goditur në këtë mënyrë konkurrencën. Kompania X.5, ka pretenduar se ka kontratë për administrimin e këtij terminali dhe ka kërkuar që asnjë koncesionar tjetër të mos hyjë brenda zonës së veprimit të kësaj kompanie.

-X.5 nuk ka disponuar kapacitetet e nevojshme për të kryer këtë shërbim, kjo referuar kërkesave që ka bërë TAP me shkresën nr. 2170 prot, datë 06.07.2015 (Prot APD), firmosur nga Sh. B në cilësinë e Menaxherit TAP Shqipëri, pa lëndë dërguar G. Sh në cilësinë e drejtorit të APD.

Disa nga dokumentet shkresore që komprometojnë procesin e ngarkim shkarkimit të tubacionit TAP, si dhe përfshirjen e personave zyrtarë të implikuar në këtë proces (Drejtori i APD, Drejtori i DPD, Ministri i MTI dhe vetë kompaninë koncesionare X.5), janë si më poshtë:

-Me shkresën nr. 873/2 prot, datë 18.03.2016 APD, firmosur nga G. Sh në cilësinë e drejtorit të përgjithshëm, i është drejtuar K. R, president i Trans Adriatic Pipeline AG (Dega e zyrës Shqipëri) dhe për dijeni Ch. G, në cilësinë e drejtorit të X.5 Shqipëri me lëndë “Përgjigje e letres tuaj” ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “...Duke marrë parasysh rëndësinë e veçantë të projektit TAP për vendin tonë, bazuar në informacionet e operatorit të Terminalit Lindor X.5, mbi kontratën e lidhur me kompaninë e prodhimit të tubave Mannesman, si dhe ekspertizës së mobilizuar sakaq në Terminalin Lindor, për të pritur ngarkesën e parë që është parashikuar më datën 4 prill 2016 dhe në vijim, për të gjitha anijet e tjera me këto lloj ngarkese, dëshiroj t’ju bëjë me dije se APD në bashkëpunim me autoritetin kontraktor dhe njësinë e zbatimit të projektit koncesionar, gjithashtu bazuar në kontratën koncesionare, do të autorizojë Shoqërinë X.5, si operator i Terminalit Lindor, të kryejë procesin e shkarkimit të tubave të projektit TAP”.

-Me shkresën nr. 1147 prot, datë 05.04.2016 (prot., APD), firmosur nga K. R, në cilësinë e Menaxherit të Projektit, me lëndë “Kthim përgjigje”, dërguar R. R përfaqësues i shoqërisë “X.34”, L. H përfaqësues i shoqërisë “X.32”, A. B përfaqësues i shoqërisë “X.7”, si dhe për dijeni G. Sh në cilësinë e drejtorit të përgjithshëm ekzekutiv APD, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “...TAP e merr shumë seriozisht çështjen e sigurisë, së bashku me përzgjedhjen e kontraktorit dhe menaxhimin. Ju lutemi, rrini të qetë sepse është marrë kujdesi i duhur në kompetencën e operimeve të terminalit, të menaxhuar nga X.5 në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit. Gjithashtu vini re se manovrimi i ngarkesës së tubave do të mbikëqyret nga specialist ndërkombëtar me përvojë në procesin e ngritjes së ngarkesave, të cilat kanë njohuri të shumta për menaxhimin e këtij lloji shkarkimi të tubave prej çeliku të ngarkesës së anijes. Gjithashtu, ne do të donim të sillnim në vëmendjen tuaj se TAP, ka marrë një letër mbështetje më datë 18.03.2016 nga Drejtori i APD, i cili shprehte mbështetjen e tij për punën dhe autorizimin e X.7, për të kryer shkarkimin e tubave për projektin TAP në Terminalin Lindor” (shkresa nr. 873/2 prot, datë 18.03.2016 APD)”.

-Autorizimi me nr. 370/2 prot, datë 23.09.2015 i lëshuar nga drejtori i drejtorisë detare, është në kundërshtim me;

1. Shkresën nr. 1409/1, datë 11.04.2016 të E. H në cilësinë e Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, protokolluar në APD me shkresën nr. 873/1 datë 12.04.2016 me lëndë “Kthim përgjigje” ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “...Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, pasi shqyrtoj shkresën tuaj nr. 873 prot, datë 17.03.2016 vlerëson se: Neni 2.1 i kontratës koncensionare parashikon se operimi i terminalit, do të përfshijë ngarkimin, shkarkimin kryesisht të anijeve me ngarkesë rifuxho minerale, qymyr etj. por edhe të anijeve me ngarkesë për projekte sipas rastit dhe se përpunimi aktual i anijeve në Terminalin Lindor, mund të shihet në këtë kategori. Në vijim, përsa i përket autorizimit të kërkuar nga ana juaj ju bëjmë me dije se ky autorizim lëshohet nga administrata detare, nëse është e nevojshme, bazuar në kërkesën e subjektit, siç përcaktohet në nenin 3 të kontratës koncensionare”.

Në fakt autorizimi është dhënë me nr. 370/2 prot, datë 23.09.2015, pra afërsisht 7 muaj, para delegimit të kompetencës nga Ministri, kështu që s’ka të bëjë me këtë proces.

2. Ligjin nr. 9130, datë 08.09.2003 “Autoriteti Portual”, neni 15 “Detyrat dhe të drejtat e këshillit drejtues”, pika 1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Këshilli Drejtues i një porti është organi i vetëm përgjegjës për drejtimin e veprimtarisë së autoritetit portual të portit dhe që ushtron të drejtat mbi pronën si “Port administrues i pronës”. Neni 20 “Përgjegjësitë e drejtorit ekzekutiv dhe marrëdhëniet me nëpunësit”, pika 3.

3. VKM nr. 596, datë 10.09.2004 “Për miratimin e statusit të Autoritetit Portual Durrës dhe për riorganizimin e tij” neni 9 “Detyrat dhe të drejtat e Këshillit Drejtues”, pika 1.

-Me shkresën nr. 4851 prot, datë 22.09.2015 të E. H në cilësinë e Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme Detare me nr. 370 datë 23.09.2015 me lëndë “Mbi problematikën e operimit të Koncensionarit “X.5”, në Terminalin Lindor të Portit Durrës, drejtuar drejtorit të drejtorisë së Përgjithshme Detare dhe G. Sh në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të APD ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “...Në nenin 2, objekti i koncesionit, të kontratës koncensionare të lidhur ndërmjet Ministrisë së Punëve Publike (sot MTI) dhe operatorit “X.5”, parashikohet se këtij të fundit i jepet e drejta e ngarkim shkarkimit për Terminalin Lindor të Portit të Durrës. Në këto kushte ju bëjmë me dije se parashikimi i këtij kushti ligjor, nënkupton ezaurimin e konkursit për dhënien e licencës për këtë operator në këtë zonë të portit Durrës. Ajo çka duhet të bëjë institucioni juaj është verifikimi i kapaciteteve teknike ligjore të operatorit X.5, e në rast përmbushje të tyre të procedohet në dhënien e të drejtës së operimit në kalatën lindore. Gjithashtu drejtoria e Përgjithshme Detare të marrë masat e duhura për licencimin e operatorit “X.5”, pas verifikimit të kushteve të sipërpërmendura. Gjithashtu referuar APD ku ju propozoni se X.5 duhet të operojë në terminalin lindor dhe vetëm në ato raste kur ajo është kontraktuar nga përdoruesit e portit. X.5 nuk duhet në asnjë rast të diskriminojë apo të pengojë shoqëritë e tjera stivadore të operojnë në terminalin lindor”, duke mbajtur parasysh parimet e portit të hapur, ku parashikohet respektimi i kushteve të njëjta të konkurrencës në lidhje me operatorët e tjerë që operojnë në territorin e portit tuaj, MTI, shprehet parimisht dakord”.

Nga mos përpunimi i tubacioneve të TAP nga APD, Autoritetit Portual Durrës dhe Buxhetit të Shtetit i janë krijuar të ardhura të munguara në **vlerën 71,168,800 lekë (67,568,800 përpunimi dhe 3,600,000 detyrim për pajisje me kontratë licence).**

Referuar të dhënave të dhëna nga organizata Albanian Platform for Policy Advoca “Platforma Shqiptare për Advokimin e Politikave” në lidhje me këtë çështje, me të cilën KLSH ka lidhur marrëveshje në Prill 2016, sasia e tubacionit, pjesëve të tyre dhe makinerive të Projektit TAP vetëm për fazën e parë të projektit 16 anije, në linjën tokësore **është në sasinë 130,000 ton (në këtë sasi nuk është përfshirë sasia për linjën detare).**

Nga përlllogaritjet e sasisë 130,000 ton, n.q.s kjo sasi do të përpunohej nga APD dhe jo nga Terminali Lindor, **APD do të krijonte një të ardhur në vlerën 78,390,000 lekë.**

Në fakt Porti i Durrësit, është i vetmi Autoritet Portual në Republikën e Shqipërisë, që gëzon të drejtën e dhënë nga ligji, për organizimin e shpërndarjen e ngarkesave (cargo) nëpër терминаlet e tij sipas profilit të mallrave. APD disponon asetet e nevojshme infrastrukturore, makineritë dhe pajisjet për procesin e shkarkimit, depozitimit dhe evadimit të tubacioneve, materialeve të nevojshme, si dhe makinerive të projektit TAP.

Sipas opinionit tonë: Referuar dokumentacionit të cituar si mësipër, grupi i auditimit nuk mund të jap një opinion të plotë dhe të saktë, mbi zbatimin e kuadrit rregullator mbi të cilin ka vepruar Autoriteti Portual Durrës, Drejtoria e Përgjithshme Detare, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës në lidhje me *procesin e shkarkimit, depozitimit dhe evadimit të tubacioneve, materialeve të nevojshme, si dhe makinerive të projektit TAP nga kompania X.5*, si dhe grupi i auditimit shprehet me rezervë për saktësinë dhe vërtetësinë e *vlerës 71,168,800 lekë* (vlerë e cila në këto kushte vlerësohet si e ardhur e munguar për llogari të Autoritetit Portual Durrës dhe Buxhetit të Shtetit, si dhe përgjegjësinë ligjore dhe ekonomike të personave zyrtar të përfshirë në këtë proces, të: Autoritetit Portual Durrës, Drejtorisë së Përgjithshme Detare, si dhe të Ministrisë të Transportit dhe Infrastrukturës, që me veprimet dhe mos veprimet e tyre në zbatim të kompetencave që ju jep ligji, kanë kryer përmbushjen ose jo të rregullt të detyrës, me pasojë prekjen e interesave të ligjshme të APD dhe të Shtetit.

Vlera 71,168,800 lekë është e ardhur e munguar për APD dhe Buxhetin e Shtetit (Trajtuar më hollësisht në faqet 210-237, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të prezantohet në organet drejtuese vlera **71,168,800 lekë**, që ka të bëjë me procesin e shkarkimit, depozitimit dhe evadimit të tubacioneve, materialeve të nevojshme si dhe makinerive të Projektit TAP, të realizuar nga kompania X.5 dhe jo nga Porti i Durrësit, i cili është i vetmi Autoritet Portual në Republikën e Shqipërisë, që gëzon të drejtën e dhënë nga ligji, për organizimin e shpërndarjen e ngarkesave (cargo) nëpër терминаlet e tij sipas profilit të mallrave. APD disponon asetet e nevojshme infrastrukturore, makineritë dhe pajisjet për procesin e shkarkimit, depozitimit dhe evadimit të tubacioneve, materialeve të nevojshme, si dhe makinerive të projektit TAP, duke krijuar të **ardhura të munguara** për APD dhe Buxhetin e Shtetit në vlerën **71,168,800 lekë**, vetëm për linjën tokësore, pa përfshirë atë detare që është dhe pjesa më e rëndësishme e projektit. Konkretisht: Shkarkimi nga kompania X.5 i tubacioneve të TAP dhe të materialeve të tjera në funksion të tyre, është kryer pa licencën e stivadorit, në kundërshtim me pikën 3.2. 1 të kontratës koncensionare, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: *“Do t’i sigurojë Konçesionarit Lejet, Autorizimet, Liçensat e kërkuara për zbatimin e kësaj kontrate, që janë në kompetencë të Autoritetit Kontraktues apo APD, me kusht që Konçesionari të ketë plotësuar dhe paraqitur të gjithë dokumentacionin e rregullt ligjor për lëshimin e tyre”*.

Organet drejtuese të APD të analizojnë dhe të denoncojnë përgjegjësinë ligjore dhe ekonomike të personave zyrtarë të përfshirë në këtë proces, që me veprimet dhe mos veprimet e tyre në zbatim të kompetencave që ju jep ligji, kanë kryer përmbushjen ose jo të rregullt të detyrës, me pasojë prekjen e interesave ligjshme të APD dhe të Shtetit.

Brenda datës 31.12.2016

C. MASA DISIPLINORE

C.I. Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, statutit të shoqërisë neni 12, i kërkojmë Ministrin të Transportit dhe Infrastrukturës dhe Këshillit Drejtues, që në varësi të kompetencave të tyre ligjore, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“Largim nga puna” për:

1. G. Sh me detyrë drejtor i përgjithshëm ekzekutiv për periudhën 10.02.2015 dhe në vazhdim.

Për arsye se me veprimet dhe mos veprimet e tij ka kryer:

-Nënshkrimin dhe zbatimin e marrëveshjes nr. 614 prot, datë 25.02.2015 të lidhur ndërmjet APD, Drejtorisë së Përgjithshme Detare dhe Shoqërisë "X.8", për vlerësimin e planit të sigurisë, e cila është kryer pa procedurë prokurimi, veprim në kundërshtim me nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1.

Pretendimi për karakterin sekret të këtij shërbimi është keq interpretim i ligjit të mësipërm dhe është bërë me qëllim për të abuzuar me fondet publike, po ti referohesh ekstraktit të regjistrit tregtar aksionet e kësaj shoqërie 25 % zotërohen nga aksionar shqiptar, **ndërsa 75 % e tyre zotërohen nga aksionar të huaj të panjohur dhe të pa autorizuar nga organet e ngarkuara me ligj për sigurinë kombëtare, në këto kushte grupi i auditimit shprehet me rezervë për ruajtjen e sigurisë kombëtare.**

Shtuar dhe faktit se ky plani sigurie portuale është cënuar në rastet si më poshtë:

-Për 4 punonjës të cilët janë emëruar gjatë periudhës Janar - Qershor 2015, të cilët referuar shkresës nr. 4022/1, datë 24.11.2015, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, **kanë qenë të shpallur në kërkim për vepra të ndryshme penale si "Kontrabandë me mallra të ndaluar", "Plagosje e lehtë me dashje", "Vrasje me dashje e mbetur në tentativë" dhe "Trafikim i lëndëve narkotike".** Emërimi i këtyre personave në detyra të ndryshme pranë FSPD, është kryer në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 242, datë 23.04.2014 "Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së punonjësve të forcave të sigurisë në portet e Republikës së Shqipërisë", neni 2, pika 5.

-Porta që lidh APD me portin e ri të peshkimit, pasi kjo portë nuk përfshihet në planin e sigurisë detare, të miratuar nga Ministri, si autoriteti më i lartë i sigurisë portuale. Thëkssojmë se porti i ri i peshkimit nuk përfshihet në planin e sigurisë së Portit të Durrësit, nuk implementon kodin ISPS, si dhe mjete ujore që operojnë në këtë port nuk kontrollohen nga FSPD, por nga policia kufitare dhe institucione të tjera në juridiksionin detar.

-Ekzistenca e dy portave hyrëse dhe dalëse në Terminalin Lindor, të cilat nuk përfshihen në planin e sigurisë detare, të miratuar nga Ministri, si autoriteti më i lartë i sigurisë portuale. Porta nr. 5, bazuar në rekomandimin e kompanisë që ka kryer vlerësimin e rrezikut në Portin e Durrësit, duhet të ishte mbyllur, ndërsa porta e emergjencës duhet të funksionoj si hyrëse dhe dalëse për në Terminalin Lindor.

Pra vetëm plan sigurie portuale nuk mund të konsiderohet.

Për pos kësaj,

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit, nuk vërtetohet kryerja e këtij shpenzimi, pasi produkti (plani i sigurisë) nuk u vu në dispozicion të grupit të auditimit, me pretendimin e sekretit të sigurisë portuale, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 26, pika 1, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 4, pika 26, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 35, gërma a, Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 6.

-Mos vënien në punë të peshores elektronike me vlerë investimi **47,994,000 lekë**, pasi ky investim, nuk ka justifikuar kryerjen e këtij shpenzimi, që ka të bëjë me instalimin e sistemit të integruar të peshimit elektronik, i cili duhet të përshpejtojë procedurat e brendshme të operimit, rritjen e sigurisë së veprimeve të brendshme, mirë administrimin e të ardhurave të Autoritetit Portual, si dhe rritjen e cilësisë dhe shpejtësisë së shërbimit përkundrejt operatorëve, për pos kësaj në Terminalin e Kontejnerëve në vitin 2015 është ndërtuar një peshore tjetër, pa asnjë dokumentacion, dhënë me qira ose me enfitëozë të sipërfaqes së

ndërtimit, ose blerë sipërfaqen e truallit që ajo zë, leje ndërtimi etj. Sipas deklaramit verbal të R. K me detyrë përgjegjës i sektorit të kontratave koncensionare, kjo peshore është ndërtuar nga Dogana Durrës. N.q.s do të jetë i vërtetë ky fakt, Dogana Durrës në këtë terminal disponon dy peshore dhe APD disponon dy peshore elektronike. Pra të ardhurat nga peshimi i ngarkesave në përpunimin e anijeve kalojnë për llogari të Doganës Durrës dhe jo të APD. **Vlera 47,994,000 lekë është dëm ekonomik për APD dhe Buxhetin e Shtetit.**

-Nënshkrimin dhe zbatimin të aktmarrëveshjes nr. 1857 prot, datë 10.06.2015 (Prot., APD) dhe nr. 834 prot, datë 10.06.2015 (Prot., Nj.Z.P), firmosur nga G. Sh dhe për Njësinë e Zbatimit të Projektit (Nj.Z.P) të firmosur nga Xh. T, për faturën nr, 39, datë 31.05.2012, **në vlerën 726,073 euro.**

Aktmarrëveshja është në kundërshtim me:

-Ligjin nr. 9691, datë 08.03.2007 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve (BEI) për financimin me kredi të Projektit “Ndërtimi i Terminalit të trageteve dhe shesheve përreth në Portin e Durrësit”.

-Ligjin nr. 9758, datë 21.06.2007 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për marrëveshjen e kredisë ndërmjet Autoritetit Portual Durrës dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për financimin e projektit “Ndërtimi i terminalit të trageteve dhe i shesheve përreth në Portin e Durrësit”.

-Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 775, datë 24.09.2010 “Për administrimin e financimeve të huaja në Republikën e Shqipërisë”.

-VKM nr. 692, datë 10. 11.2005 “Për miratimin e strategjisë së ripunuar “Konsolidimi i një sistemi planifikimi të integruar në Shqipëri”, pika 6.

-Rregulloren e brendshme të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 69 datë 15.10.2012 të Këshillit Drejtues të APD, pika 4 Këshilli Drejtues, nënpika 7/i.

-VKM nr. 596, datë 10.9.2004 “Për miratimin e statutit të Autoritetit Portual Durrës dhe për riorganizimin e tij”, neni 9.

-Udhëzimin e MF nr. 36, datë 10.08. 2009 “Për hartimin e regjistrit të borxhit shtetëror dhe garancive shtetërore të huasë”, neni 2.

-Udhëzimin e MF nr. 22, datë 05.10.2011 “Për publikimin e të dhënave të borxhit të qeverisjes së përgjithshme dhe hartimin e raportit të tij” dhe neni 7, pikat 5 dhe 6.

Në zbatim të aktmarrëveshjes si mësipër:

Me kërkesë për transfertë bankare datë 15.06.2015 nga APD, është likuiduar vlera **300,000 EUR** për llogari të Njësisë së Zbatimit të Projektit BEI-BERZH, nëpërmjet

Me kërkesë për transfertë bankare datë 15.06.2015 nga APD, është likuiduar vlera **149,178.15 EUR** për llogari të Njësisë së Zbatimit të Projektit BEI-BERZH, nëpërmjet

Me kërkesë për transfertë bankare datë 15.06.2015 nga APD, është likuiduar vlera **276,894.91 EUR** për llogari të Njësisë së Zbatimit të Projektit BEI-BERZH, nëpërmjet

Me pasojë dëm ekonomik për APD dhe Buxhetin e Shtetit në vlerën **486,377 EUR**. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në likuidimin nga APD për llogari Projektit BEI-BERZH për kalatën 7 dhe 8, vlerë e cila i ka kaluar shoqërisë “X.29” shpk.

-Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga APD, u konstatua se procesi i shkarkimit, depozitimit dhe evadimit të tubacioneve, materialeve të nevojshme si dhe makinerive të projektit TAP, është realizuar nga kompania X.5 dhe jo nga Porti i Durrësit, i cili është i vetmi Autoritet Portual në Republikën e Shqipërisë, që gëzon të drejtën e dhënë nga ligji, për organizimin e shpërndarjen e ngarkesave (cargo) nëpër терминаlet e tij, sipas profilit të mallrave. APD disponon asetet e nevojshme infrastrukturore, makineritë dhe pajisjet për

procesin e shkarkimit, depozitimit dhe evadimit të tubacioneve, materialeve të nevojshme, si dhe makinerive të projektit TAP, duke krijuar të ardhura të munguar për APD dhe Buxhetin e Shtetit **në vlerë 71,168,800 lekë**. Konkretisht:

Shkarkimi i tubacioneve të TAP dhe të materialeve të tjera në funksion të tyre nga kompania X.5, është kryer pa licencën e stivadorit, në kundërshtim me pikën 3.2. 1 të kontratës koncensionare.

-Nga mos pajisja me licencën së stivadorit, kompania X.5 nuk i ka paguar tarifën e ushtrimit të një aktiviteti të tillë, **në vlerën 3,600,000 lekë, vlerë e cila është e ardhur e munguar për APD dhe Buxhetin e Shtetit**.

-X.5, edhe pse e pa pajisur me licencën e stivadorit, ka vendosur monopol në këtë shërbim, pasi Porti i Durrësit nuk ka zhvilluar një procedurë për të përzgjedhur kompaninë stivadore, pra nuk ka patur një konkurrencë në këtë shërbim, në kundërshtim me ligjin nr. 9251, datë 08.07.2004 “Kodi detar i Republikës së Shqipërisë.

Kompania koncesionare X.5, edhe pse e pa pajisur me licencën e stivadorit, nuk ka lejuar shoqëritë e licencuara të ngarkim-shkarkimit (stivadorët) të kryejnë përpunimin e anijeve duke krijuar, në këtë mënyrë një monopol të paligjshëm në ofrimin e shërbimeve në Terminalin Lindor dhe goditur në këtë mënyrë konkurrencën. Kompania X.5, ka pretenduar se ka kontratë për administrimin e këtij terminali dhe ka kërkuar që asnjë koncesionar tjetër të mos hyjë brenda zonës së veprimit të kësaj kompanie.

-X.5 nuk ka disponuar kapacitet e nevojshme për të kryer këtë shërbim, kjo referuar kërkesave që ka bërë TAP me shkresën nr. 2170 prot, datë 06.07.2015 (Prot APD), firmosur nga Sh. B, në cilësinë e Menaxherit TAP Shqipëri, pa lëndë dërguar G. Sh në cilësinë e drejtorit të APD.

Disa nga dokumentet shkresore që komprometojnë procesin e ngarkim shkarkimit të tubacionit TAP, si dhe përfshirjen e personave zyrtarë të implikuar në këtë proces (Drejtori i APD, Drejtori i DPD, Ministri i MTI dhe vetë kompaninë koncensionare X.5), janë si më poshtë:

-Me shkresën nr. 873/2 prot, datë 18.03.2016 APD, firmosur nga G. Sh në cilësinë e drejtorit të përgjithshëm, i është drejtuar K. R, president i Trans Adriatic Pipeline Ag (Dega e zyrës Shqipëri) dhe për dijeni Ch. G, në cilësinë e drejtorit të X.5 Shqipëri me lëndë “Përgjigje e letrës tuaj” ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “...Duke marrë parasysh rëndësinë e veçantë të projektit TAP për vendin tonë, bazuar në informacionet e operatorit të Terminalit Lindor X.5, mbi kontratën e lidhur me kompaninë e prodhimit të tubave Mannesman, si dhe ekspertizës së mobilizuar sakaq në Terminalin Lindor, për të pritur ngarkesën e parë që është parashikuar më datën 4 prill 2016 dhe në vijim, për të gjitha anijet e tjera më këtë lloj ngarkese, dëshiroj t’ju bëjmë me dije se APD në bashkëpunim me autoritetin kontraktor dhe njësinë e zbatimit të projektit koncensionar, gjithashtu bazuar në kontratën koncensionare, do të autorizojë Shoqërinë X.5, si operator i Terminalit Lindor, të kryejë procesin e shkarkimit të tubave të projektit TAP”.

-Me shkresën nr. 1147 prot, datë 05.04.2016 (prot., APD), firmosur nga K. R, në cilësinë e Menaxherit të Projektit, me lëndë “Kthim përgjigje”, dërguar R. R përfaqësues i shoqërisë “X.34”, L. H përfaqësues i shoqërisë “X.32”, A. B përfaqësues i shoqërisë “X.7”, si dhe për dijeni G. Sh në cilësinë e drejtorit të përgjithshëm APD, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “...TAP e merr shumë seriozisht çështjen e sigurisë, së bashku me përzgjedhjen e kontraktorit dhe menaxhimin. Ju lutemi, rri në të qetë sepse është marrë kujdesi i duhur në kompetencën e operimeve të terminalit, të menaxhuar nga X.5 në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit. Gjithashtu vini re se manovrimi i ngarkesës së tubave do të mbikëqyret nga specialist ndërkombëtar me përvojë në procesin e ngritjes së ngarkesave, të cilët kanë njohuri të shumta për menaxhimin e këtij lloji shkarkimi të tubave prej çeliku të ngarkesës së anijes. Gjithashtu, ne do të donim të sillnim në vëmendjen tuaj se TAP, ka marrë një letër mbështetje

më datë 18.03.2016 nga Drejtor i APD, i cili shprehte mbështetjen e tij për punën dhe autorizimin e X.5, për të kryer shkarkimin e tubave për projektin TAP në Terminalin Lindor” (shkresa nr. 873/2 prot, datë 18.03.2016 APD).

-Autorizimi me nr. 370/2 prot, datë 23.09.2015 i lëshuar nga drejtori i drejtorisë detare, është në kundërshtim me;

-1. Shkresën nr. 1409/1, datë 11.04.2016 të E. H në cilësinë e Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, protokolluar në APD me shkresën nr. 873/1 datë 12.04.2016 me lëndë “Kthim përgjigje” ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “...*Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, pasi shqyrtoj shkresën tuaj nr. 873 prot, datë 17.03.2016 vlerëson se: Neni 2.1 i kontratës koncensionare parashikon se operimi i terminalit, do të përfshijë ngarkimin, shkarkimin kryesisht të anijeve me ngarkesë rifuxho minerale, qymyr etj. por edhe të anijeve me ngarkesë për projekte sipas rastit dhe se përpunimi aktual i anijeve në Terminalin Lindor, mund të shihet në këtë kategori. Në vijim, përsa i përket autorizimit të kërkuar nga ana e juaj ju bëjmë me dije se ky autorizim lëshohet nga administrata detare, nëse është e nevojshme, bazuar në kërkesën e subjektit, siç përcaktohet në nenin 3 të kontratës koncensionare”.*

Në fakt autorizimi është dhënë me nr. 370/2 prot, datë 23.09.2015, pra afërsisht 7 muaj, para delegimit të kompetencës nga Ministri, kështu që s’ka të bëjë me këtë proces.

2. Ligjin nr. 9130, datë 08.09.2003 “Autoriteti Portual”, neni 15 “Detyrat dhe të drejtat e Këshillit Drejtues”, pika 1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Këshilli Drejtues i një porti është organi i vetëm përgjegjës për drejtimin e veprimtarisë së autoritetit portual të portit dhe që ushtron të drejtat mbi pronën si “Port administrues i pronës”. Neni 20 “Përgjegjësitë e drejtorit ekzekutiv dhe marrëdhëniet me nëpunësit”, pika 3.

3. VKM nr. 596, datë 10.09.2004 “Për miratimin e statusit të Autoritetit Portual Durrës dhe për riorganizimin e tij” neni 9 “Detyrat dhe të drejtat e Këshillit Drejtues”, pika 1.

-Me shkresën nr. 4851 prot, datë 22.09.2015 të E. H në cilësinë e Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme Detare me nr. 370 datë 23.09.2015 me lëndë “Mbi problematikën e operimit të Koncensionarit “X.5”, në Terminalin Lindor të Portit Durrës, drejtuar drejtorit të drejtorisë së Përgjithshme Detare, G. Sh në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të APD ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “...*Në nenin 2, objekti i koncesionit, të kontratës koncensionare të lidhur ndërmjet Ministrisë së Punëve Publike (sot MTI) dhe operatorit X.5, parashikohet se këtij të fundit i jepet e drejta e ngarkim shkarkimit për Terminalin Lindor Portit Durrës. Në këto kushte ju bëjmë me dije se parashikimi i këtij kushti ligjor, nënkupton ezaurimin e konkursit për dhënien e licencës për këtë operator në këtë zonë të portit Durrës. Ajo çka duhet të bëjë institucioni juaj është verifikimi i kapaciteteve teknike ligjore të operatorit X.5, e në rast përmbushje të tyre të procedohet në dhënien e të drejtës së operimit në kalatën lindore. Gjithashtu drejtorja e Përgjithshme Detare të marr masat e duhura për licencimin e operatorit X.5, pas verifikimit të kushteve të sipërpërmendura. Gjithashtu referuar APD ku ju propozoni se X.5 duhet të operojë në terminalin lindor dhe vetëm në ato raste kur ajo është kontraktuar nga përdoruesit e portit. X.5 nuk duhet në asnjë rast të diskriminojë apo të pengojë shoqëritë e tjera stivadore të operojnë në terminalin lindor”, duke mbajtur parasysh parimet e portit të hapur, ku parashikohet respektimi i kushteve të njëjta të konkurrencës në lidhje me operatorët e tjerë që operojnë në territorin e portit tuaj, MTI, shprehet parimisht dakord”.*

Nga mos përpunimi i tubacioneve të TAP nga APD, Autoritetit Portual Durrës dhe Buxhetit të Shtetit i është krijuar një e ardhur e munguar në **vlerën 71,168,800 lekë (67,568,800 përpunimi dhe 3,600,000 detyrim për pajisje me kontrate licence).**

Referuar të dhënave të dhëna nga organizata Albanian Platform for Policy Advoca “Platforma Shqiptare për Advokimin e Politikave” në lidhje me këtë çështje, me të cilën KLSH ka lidhur marrëveshje në Prill 2016, sasia e tubacionit, pjesëve të tyre dhe makinerive

të Projektit TAP vetëm për fazën e parë të projektit 16 anije, në linjën tokësore *është në sasinë 130,000 ton (në këtë sasi nuk është përfshirë sasia për linjën detare).*

Nga përlllogaritjet e sasisë 130,000 ton, n.q.s kjo sasi do të përpunohej nga APD dhe jo nga Terminali Lindor, *APD do të krijonte të ardhura në vlerën 78,390,000 lekë.*

Në fakt Porti i Durrësit, është i vetmi Autoritet Portual në Republikën e Shqipërisë, që gëzon të drejtën e dhënë nga ligji, për organizimin e shpërndarjen e ngarkesave (cargo) nëpër терминаlet e tij sipas profilit të mallrave. APD disponon asetet e nevojshme infrastrukturore, makineritë dhe pajisjet për procesin e shkarkimit, depozitimit dhe evadimit të tubacioneve, materialeve të nevojshme, si dhe makinerive të projektit TAP.

Sipas opinionit tonë: Referuar dokumentacionit të cituar sa mësipër, grupi i auditimit nuk mund të jap një opinion të plotë dhe të saktë, mbi zbatimin e kuadrit rregullator mbi të cilin ka vepruar Autoriteti Portual Durrës, Drejtoria e Përgjithshme Detare, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës në lidhje me *procesin e shkarkimit, depozitimit dhe evadimit të tubacioneve, materialeve të nevojshme, si dhe makinerive të projektit TAP nga kompania X.5*, si dhe grupi i auditimit shprehet me rezervë për saktësinë dhe vërtetësinë e *vlerës 71,168,800 lekë* (vlerë e cila në këto kushte vlerësohet si e ardhur e munguar për llogari të Autoritetit Portual Durrës dhe Buxhetit të Shtetit, si dhe përgjegjësinë ligjore dhe ekonomike të personave zyrtar të përfshirë në këtë proces, të: Autoritetit Portual Durrës, Drejtorisë së Përgjithshme Detare, si dhe të Ministrisë të Transportit dhe Infrastrukturës, që me veprimet dhe mos veprimet e tyre në zbatim të kompetencave që ju jep ligji, kanë kryer përmbushjen ose jo të rregullt të detyrës, me pasojë prekjen e interesave të ligjshme të APD dhe të Shtetit. *Vlera 71,168,800 lekë është e ardhur e munguar për APD dhe Buxhetin e Shtetit.*

C.2. Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, statutit të shoqërisë neni 12, si dhe kontratave individuale të punës, i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“Largim nga puna”, për:

1. Xh. T, në cilësinë e drejtorit i PIU BEI BERZH, për arsye se:

Të nënshkruarit dhe zbatimit të aktmarrëveshjes nr. 1857 prot, datë 10.06.2015 (Prot., APD) dhe nr. 834 prot, datë 10.06.2015 (Prot., Nj.Z.P), firmosur nga G. Sh dhe për Njësinë e Zbatimit të Projektit të firmosur nga Xh. T, për faturën nr, 39, datë 31.05.2012 *në vlerën 726,073 euro.* Aktmarrëveshja është në kundërshtim me:

-Ligjin nr. 9691, datë 08.03.2007 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve (BEI) për financimin me kredi të Projektit “Ndërtimi i Terminalit të trageteve dhe shesheve përreth në Portin e Durrësit”.

-Ligjin nr. 9758, datë 21.06.2007 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për marrëveshjen e kredisë ndërmjet Autoritetit Portual Durrës dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për financimin e projektit “Ndërtimi i Terminalit të trageteve dhe i shesheve përreth në Portin e Durrësit”.

-Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 775, datë 24.09.2010 “Për administrimin e financimeve të huaja në Republikën e Shqipërisë”.

-VKM nr. 692, datë 10. 11.2005 “Për miratimin e strategjisë së ripunuar “Konsolidimi i një sistemi planifikimi të integruar në Shqipëri”, pika 6.

-Rregulloren e brendshme të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 69 datë 15.10.2012 të Këshillit Drejtues të APD, pika 4 Këshilli Drejtues, nënpika 7/i.

-VKM nr. 596, datë 10.9.2004 “Për miratimin e statutit të Autoritetit Portual Durrës dhe për riorganizimin e tij”, neni 9.

-Udhëzimin e MF nr. 36, datë 10.08. 2009 “Për hartimin e regjistrit të borxhit shtetëror dhe garancive shtetërore të huasë”, neni 2.

-Udhëzimin e MF nr. 22, datë 05.10.2011 “Për publikimin e të dhënave të borxhit të qeverisjes së përgjithshme dhe hartimin e raportit të tij” dhe neni 7, pikat 5 dhe 6.

Në zbatim të aktmarrëveshjes si mësipër: Me kërkesë për transfertë bankare datë 15.06.2015 nga APD, është likuiduar vlera **300,000 EUR** për llogari të Njesisë së Zbatimit të Projektit BEI-BERZH, nëpërmjet

Me kërkesë për transfertë bankare datë 15.06.2015 nga APD, është likuiduar vlera **149,178.15 EUR** për llogari të Njesisë së Zbatimit të Projektit BEI-BERZH, nëpërmjet

Me kërkesë për transfertë bankare datë 15.06.2015 nga APD, është likuiduar vlera **276,894.91 EUR** për llogari të Njesisë së Zbatimit të Projektit BEI-BERZH, nëpërmjet

Me pasojë **dëm ekonomik** për APD dhe Buxhetin e Shtetit në vlerën **486,377 EUR**. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në likuidimin nga APD për llogari Projektit BEI-BERZH për kalatën 7 dhe 8, vlerë e cila i ka kaluar shoqërisë “X.29” shpk.

2. A. Gj, me detyrë menaxher i Terminalit Perëndimor, për arsye se:

-Për periudhën 11.02.2016-29.02.2016, ka urdhëruar hartimin dhe nënshkrimin e përlllogaritjes së performancës operacionale, nga specialistja i performancës operacionale L. A për periudhën që nuk ka qenë në këtë detyrë (e cila është emëruar në këtë pozicion me 11.04.2016).

-Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Zbatim-ndërtim i bazamentit të sillosave të drithit dhe spostimin e tyre në sheshin pas kalatës 2”, u konstatua se shpallja fitues e operatorit ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratës, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurës administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 115-120, **duke krijuar një dëm ekonomik në vlerën 59,222 lekë**.

-Në 3 procedura tenderimi, kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurës administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 115-120, çka ngarkon me përgjegjësi komisionet e vlerësimit të ofertave.

3. Sh. H, me detyrë drejtor i drejtorisë së mjedisit, sigurimit teknik, mbrojtjes së shëndetit dhe emergjencave, për arsye se:

-Për periudhën 01.11.2013–30.04.2016 u konstatua se mjeti autoambulancë, me targë, ka tërhequr sasinë e 3353 litrave naftë. Kjo sasi karburanti nuk duhet të rëndonte shpenzimet e APD, pasi Terminali i trageteve i cili ka kaluar me koncesion kompanisë X.6. Për pasojë për këtë shërbim duhet të ishte bërë amendim i kontratës, ku ky shpenzim të likuidohej prej tyre, siç likuidohen shpenzimet e dritave, ujit etj. Gjithashtu për drejtuesin e mjetit T. H nga data e emërimit të tij në këtë pozicion datë 13.08.2014 e në vazhdim, kartelat mujore të mjetit me targë, janë firmosur nga kushëriri i tij drejtori i drejtorisë së mjedisit Sh. H, në kushtet e konfliktit faktik dhe të vazhdueshëm të interesit, si dhe pa asnjë dokument justifikues ose provues (fletë udhëtimi). Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, neni 3, pika 1 dhe pika 4, neni 4, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

-Në kontratën nr. 514, datë 18.02.2015, me objekt “Konsulencë për laboratorin mjedisor”, me vlerë 2,352,000 lekë me tvsh, në lidhje me zbatimin e pjesës së kontratës me objekt

“Konsulencë për dokumentacionin”, në verifikimin fizik të datës 22.07.2015, për të cilin është mbajtur dhe akt-konstatimi përkatës, u konstatua se një dokumentacion i tillë nuk përdoret nga laboratorit i APD. Për pasojë, vlera e konsulencës për dokumentacion në shumën **1,704,000 lekë** (me tvsh), përbën **dëm ekonomik** për llogaritë të APD dhe Buxhetit të Shtetit. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 26, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 35, gërma a, si dhe pika 36.

-Në relacionin mbi gjendjen e detyrimeve të shoqërisë “X.7” SHPK, konstatohet se grupi i punës nuk e ka njoftuar Këshillin Drejtues se shoqëria “X.7” SHPK nuk e ka kryer detyrimin për pagimin e sigurimit të kontratës në vlerën 6,000,000 lekë.

-Në 1 procedurë tenderimi, kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurës administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 115-120, çka ngarkon me përgjegjësi komisionet e vlerësimit të ofertave.

“Zbritje në detyrë” për:

1. B. Dh, me detyrë zv/drejtor i përgjithshëm ekzekutiv, për arsye se:

-Nga auditimi ka rezultuar se me urdhër shpenzimit të datës 24.07.2014 ka përfituar padrejtësisht vlerën 2,898,000 lekë, sipas kërkesës së tij drejtuar autoritetit me nr. 1839 prot., datë 25.06.14, për zbatim të vendimit të Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Durrës me nr. 2091 datë 30.07.2013, i cili është lënë në fuqi me vendimin nr. 1263, datë 26.03.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Në këtë praktikë rezultoi se B. Dh i është paguar përveç të tjerave dhe e gjithë periudha prej 12 muaj si shpërblyer për shkëputjen nga puna në një kohë që ky punonjës referuar largimit dhe ri-emërimit në detyrë ka rezultuar vetëm me 4.5 muaj shkëputje nga puna (theksojmë se është punësuar në të njëjtin vend pune dhe nivel page). Pra shuma nga 12 muaj duhej të konvertohej në 4.55 muaj.

-Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Sistemimi i pjesës pranë rrethimit TIR në krah të rrugës- Hyrja 4- Terminali i trageteve”, u konstatua se shpallja fitues e operatorit ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratës, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurës administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 115-120, duke krijuar një dëm ekonomik në vlerën 867,353 lekë.

-Në 2 procedura tenderimi, kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurës administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 115-120, çka ngarkon me përgjegjësi komisionet e vlerësimit të ofertave.

-Në relacionin mbi gjendjen e detyrimeve të shoqërisë “X.7” SHPK, konstatohet se grupi i punës nuk e ka njoftuar Këshillin Drejtues se shoqëria “X.7” SHPK nuk e ka shlyer detyrimin për pagimin e sigurimit të kontratës në vlerën 6,000,000 lekë.

2. A. N me detyrë drejtor i drejtorisë së kontratave çështjeve ligjore dhe koncesioneve për periudhën 10.04.2009 dhe në vazhdim.

-Mos vënien në punë të peshores elektronike me vlerë investimi 47,994,000 lekë, pasi ky investim, nuk ka justifikuar kryerjen e këtij shpenzimi, që ka të bëjë me instalimin e sistemit të integruar të peshimit elektronik, i cili duhet të përshpejtojë procedurat e brendshme të operimit, rritjen e sigurisë së veprimeve të brendshme, mirë administrimin e të ardhurave të

Autoritetit Portual, si dhe rritjen e cilësisë dhe shpejtësisë së shërbimit përkundrejt operatorëve, për pos kësaj në Terminalin e kontejnerëve në vitin 2015 është ndërtuar një peshore tjetër, pa asnjë dokumentacion, dhënë me qira ose me enfiteozë të sipërfaqes së ndërtimit, ose blerë sipërfaqen e truallit që ajo zë, leje ndërtimi etj.

-Në relacionin mbi gjendjen e detyrimeve të shoqërisë “X.7” SHPK, konstatohet se grupi i punës nuk e ka njoftuar Këshillin Drejtues se shoqëria “X.7” SHPK nuk e ka shlyer detyrimin për pagimin e sigurimit të kontratës në vlerën 6,000,000 lekë.

3. R. K me detyrë përgjegjës i sektorit të kontratave koncensionare, për arsye se:

-Mos vënien në punë të peshores elektronike me vlerë investimi **47,994,000 lekë**, pasi ky investim, nuk ka justifikuar kryerjen e këtij shpenzimi, që ka të bëjë me instalimin e sistemit të integruar të peshimit elektronik, i cili duhet të përshpejtojë procedurat e brendshme të operimit, rritjen e sigurisë së veprimeve të brendshme, mirë administrimin e të ardhurave të Autoritetit Portual, si dhe rritjen e cilësisë dhe shpejtësisë së shërbimit përkundrejt operatorëve, për pos kësaj në Terminalin e kontejnerëve në vitin 2015 është ndërtuar një peshore tjetër, pa asnjë dokumentacion, dhënë me qira ose me enfiteozë të sipërfaqes së ndërtimit, ose blerë sipërfaqen e truallit që ajo zë, leje ndërtimi etj.

-Në hartimin e dokumenteve të tenderit, nuk janë dhënë argumentime mbi vendosjen e çdo kriteri të veçantë për kualifikim. Ky veprim bie në kundërshtim me Rregullat e Prokurimit Publik, të miratuara me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”.

4. G. A me detyrë drejtor i drejtorisë ekonomike për periudhën 01.04.2014-31.08.2015, për arsye se:

-Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit, nuk vërtetohet kryerja e shpenzimit të planit të sigurisë, pasi produkti (plani i sigurisë) nuk u vu në dispozicion të grupit të auditimit, me pretendimin e sekretit të sigurisë portuale, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 26 dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 35, gërma a, pika 36, Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 6. Për pasojë vlera 126,000 EUR përbën dëm ekonomik për APD dhe Buxhetin e Shtetit.

-Me kërkesë për transfertë bankare është likuiduar në vlerën 48,000 EUR për llogari të X.23 nëpërmjet, pa dokumentacion justifikues (vërtetues) dhe pa procedurë prokurimi. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 1195, datë 05.08.2008 “Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkëprodhimin e programeve a reklamave për transmetim nga operatorët radiotelevizivë ose botim në median e shkruar, dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore”.

-Nga auditimi ka rezultuar se me urdhër shpenzimin e datës 24.07.2014 është paguar nëpërmjet BKT vlera prej 2,898,000 lekë në favor të B. Dh, sipas kërkesës së tij drejtuar autoritetit me nr. 1839 prot., datë 25.06.14, për zbatim të vendimit të Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Durrës me nr. 2091 datë 30.07.2013, i cili është lënë në fuqi me vendimin nr. 1263, datë 26.03.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Në këtë praktikë rezultoi se B.Dh i është paguar përveç të tjerave dhe e gjithë periudha prej 12 muaj si shpërblim për shkëputjen nga puna në një kohë që ky punonjës referuar largimit dhe ri emërimit në detyrë ka rezultuar vetëm me 4.5 muaj shkëputje nga puna (theksojmë se është punësuar në të njëjtin vend pune dhe nivel page).

-Në relacionin mbi gjendjen e detyrimeve të shoqërisë “X.7” SHPK, konstatohet se grupi i punës nuk e ka njoftuar Këshillin Drejtues se shoqëria “X.7” SHPK nuk e ka shlyer detyrimin për pagimin e sigurimit të kontratës në vlerën 6,000,000 lekë.

-Mos vënien në punë të peshores elektronike me vlerë investimi 47,994,000 lekë, pasi ky investim, nuk ka justifikuar kryerjen e këtij shpenzimi, që ka të bëjë me instalimin e sistemit të integruar të peshimit elektronik, i cili duhet të përshpejtojë procedurat e brendshme të operimit, rritjen e sigurisë së veprimeve të brendshme, mirë administrimin e të ardhurave të Autoritetit Portual, si dhe rritjen e cilësisë dhe shpejtësisë së shërbimit përkundrejt operatorëve, për pos kësaj në Terminalin e kontejnerëve në vitin 2015 është ndërtuar një peshore tjetër, pa asnjë dokumentacion, dhënë me qira ose me enfitëozë të sipërfaqes së ndërtimit, ose blerë sipërfaqen e truallit që ajo zë, leje ndërtimi etj.

-Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për dhënien me qira të shesheve për shërbime portuale dhe ngarkim shkarkimi, Shoqërisë “X.32”, u konstatua se Autoritetit Portual Durrës dhe Buxhetit të Shtetit, i është krijuar një dëm ekonomik në vlerën 1,052,350 lekë.

5. B. V, me detyrë përgjegjës i sektorit të prokurimeve për periudhën 19.01.2015-09.05.2016, për arsye se:

-Në hartimin e dokumenteve të tenderit, nuk janë dhënë argumentime mbi vendosjen e çdo kriteri të veçantë për kualifikim. Ky veprim bie në kundërshtim me Rregullat e Prokurimit Publik, të miratuara me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”.

-Specifikimet teknike nuk janë hartuar plotësisht në përputhje me nenin 23 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pasi ato nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë marke apo emri të veçantë, patente, vizatimi ose tipi, origjinë specifike, prodhuesi ose sipërmarrje shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

-Në procedurat e zhvilluara me objekt “Zbatim-Rikonstruksioni i Zyrës së lejeve dhe disa ambienteve zyresh në godinat e APD-së” dhe “Pajisje pune dhe kontrolli mekanike dhe energjetike”, rivlerësimi, shpallja fitues e operatorit ekonomik fitues nga KVO, si dhe lidhja e kontratës, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurës administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 115-120.

“Vërejtje për Largim nga puna”, për:

1. F. S me detyrë drejtor i drejtorisë operacionale për periudhën 02.02.2013-01.09.2015, për arsye se:

-Mos vënien në punë të peshores elektronike me vlerë investimi 47,994,000 lekë, pasi ky investim, nuk ka justifikuar kryerjen e këtij shpenzimi, që ka të bëjë me instalimin e sistemit të integruar të peshimit elektronik, i cili duhet të përshpejtojë procedurat e brendshme të operimit, rritjen e sigurisë së veprimeve të brendshme, mirë administrimin e të ardhurave të Autoritetit Portual, si dhe rritjen e cilësisë dhe shpejtësisë së shërbimit përkundrejt operatorëve, për pos kësaj në Terminalin e kontejnerëve në vitin 2015 është ndërtuar një peshore tjetër, pa asnjë dokumentacion, dhënë me qira ose me enfitëozë të sipërfaqes së ndërtimit, ose blerë sipërfaqen e truallit që ajo zë, leje ndërtimi etj.

-Në relacionin mbi gjendjen e detyrimeve të shoqërisë “X.7” SHPK, konstatohet se grupi i punës nuk e ka njoftuar Këshillin Drejtues se shoqëria “X.7” SHPK nuk e ka shlyer detyrimin për pagimin e sigurimit të kontratës në vlerën 6,000,000 lekë.

2. R. Gj, me detyrë përgjegjëse e sektorit të monitorimit dhe zhvillimit të mjedisit, për arsye se:

-Në kontratën nr. 514, datë 18.02.2015, me objekt “Konsulencë për laboratorin mjedisor”, me vlerë 2,352,000 lekë me tvsh, në lidhje me zbatimin e pjesës së kontratës me objekt “Konsulencë për dokumentacionin”, në verifikimin fizik të datës 22.07.2015, për të cilin është mbajtur dhe akt-konstatimi përkatës, u konstatua se një dokumentacion i tillë nuk përdoret nga laboratori i APD. Për pasojë, vlera e konsulencës për dokumentacion në shumën 1,704,000 lekë (me tvsh), përbën dëm ekonomik për llogari të APD dhe Buxhetit të Shtetit. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 26, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 35, gërma a, si dhe pika 36.

3. E. K, me detyrë specialist i lartë pranë sektorit të prokurimeve, në cilësinë e anëtarit të komisionit të kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim.

4. A. C, me detyrë specialist i lartë pranë sektorit të mirëmbajtjes teknike, në cilësinë e anëtarit të komisionit të kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim.

-Për arsye se në zbatimin e kontratës në tenderin e zhvilluar me objekt: “Blerje vajra dhe lubrifikante”, u konstatua një përfitim i padrejtë nga shoqëria “X.13” sha në vlerën 4,419,900 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për APD dhe Buxhetin e Shtetit.

5. E. M, me detyrë specialiste e lartë pranë njësisë së laboratorit mjedisor, në cilësinë e anëtarit të komisionit të kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim.

-Për arsye se në zbatimin e kontratës në tenderin e zhvilluar me objekt: “Blerje vajra dhe lubrifikante”, u konstatua një përfitim i padrejtë nga shoqëria “X.13” sha në vlerën 4,419,900 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për APD dhe Buxhetin e Shtetit.

-Në kontratën nr. 514, datë 18.02.2015, me objekt “Konsulencë për laboratorin mjedisor”, me vlerë 2,352,000 lekë me tvsh, në lidhje me zbatimin e pjesës së kontratës me objekt “Konsulencë për dokumentacionin”, në verifikimin fizik të datës 22.07.2015, për të cilin është mbajtur dhe akt-konstatimi përkatës, u konstatua se një dokumentacion i tillë nuk përdoret nga laboratori i APD. Për pasojë, vlera e konsulencës për dokumentacion në shumën 1,704,000 lekë (me tvsh), përbën dëm ekonomik për llogari të APD dhe Buxhetit të Shtetit. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 26, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 35, gërma a, si dhe pika 36.

6. M. R, me detyrë specialist i lartë pranë sektorit të monitorimit të kontratave të mirëmbajtjes, në cilësinë e anëtarit të komisionit të kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim, për arsye se:

-Në zbatimin e kontratës në tenderin e zhvilluar me objekt: “Blerje furgon (minibus) 8+1 copë 1 dhe autoveturë (fuoristradë) 4+1 copë 1”, u konstatua një përfitim i padrejtë nga shoqëria “X.14” shpk në vlerën 8,754,350 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për APD dhe Buxhetin e Shtetit.

-Në zbatimin e kontratës në tenderin e zhvilluar me objekt: “Blerje litarë çeliku fi 10-36(ML) për elektrovinça”, u konstatua një përfitim i padrejtë nga shoqëria “X.15” në vlerën 68,988 EUR, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për APD dhe Buxhetin e Shtetit.

7. Sh. Xh, me detyrë zv. drejtor operativ i Forcës së Sigurisë së Portit të Durrësit, në cilësinë e anëtarit të komisionit të kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim.

8. T. Gj, me detyrë përgjegjëse e njësisë së shërbimeve mbështetëse, në cilësinë e anëtarit të komisionit të kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim.

Për arsye se në zbatimin e kontratës në tenderin e zhvilluar me objekt: “Blerje furgon (minibus) 8+1 copë 1 dhe autoveturë (fuoristradë) 4+1 copë 1”, u konstatua një përfitim i

padrejtë nga shoqëria “X.14” shpk në vlerën 8,754,350 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për APD dhe Buxhetin e Shtetit.

9. L. K, me detyrë specialiste e lartë pranë njësisë së vlerësimit të nevojave, në cilësinë e anëtarit të komisionit të kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim, për arsye se:

-Në zbatimin e kontratës në tenderin e zhvilluar me objekt: “Blerje litarë çeliku fi 10-36(ML) për elektrovinça”, u konstatua një përfitim i padrejtë nga shoqëria “X.15” në vlerën 68,988 EUR, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për APD dhe Buxhetin e Shtetit.

-Në zbatimin e kontratës në tenderin e zhvilluar me objekt: “Pjesë këmbimi elektrike për mirëmbajtjen e rrjetit elektrik TU dhe TM”, u konstatua një përfitim i padrejtë nga shoqëria “X.16” shpk në vlerën 15,111,792 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për APD dhe Buxhetin e Shtetit.

10. L. M, me detyrë specialist i lartë pranë sektorit të monitorimit të kontratave të mirëmbajtjes, në cilësinë e anëtarit të komisionit të kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim.

11. A. B, me detyrë specialist i lartë pranë njësisë së sigurimit teknik, në cilësinë e anëtarit të komisionit të kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim.

Për arsye se në zbatimin e kontratës në tenderin e zhvilluar me objekt: “Pjesë këmbimi elektrike për mirëmbajtjen e rrjetit elektrik TU dhe TM”, u konstatua një përfitim i padrejtë nga shoqëria “X.16” shpk në vlerën 15,111,792 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për APD dhe Buxhetin e Shtetit.

12. S. D, me detyrë specialist i lartë pranë njësisë së laboratorit mjedisor, për arsye se:

-Në kontratën nr. 514, datë 18.02.2015, me objekt “Konsulencë për laboratorin mjedisor”, me vlerë 2,352,000 lekë me tvsh, në lidhje me zbatimin e pjesës së kontratës me objekt “Konsulencë për dokumentacionin”, në verifikimin fizik të datës 22.07.2015, për të cilin është mbajtur dhe akt-konstatimi përkatës, u konstatua se një dokumentacion i tillë nuk përdoret nga laboratorit i APD. Për pasojë, vlera e konsulencës për dokumentacion në shumën 1,704,000 lekë (me tvsh), përbën dëm ekonomik për llogari të APD dhe Buxhetit të Shtetit. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 26, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 35, gërma a, si dhe pika 36.

C.3. Gjatë trajtimit të çështjeve në Raportin Përfundimtar të auditimit janë konstatuar përgjegjësi të natyrës administrative, për personat që nuk janë në marrëdhënie pune me APD, të cilat do të vlerësoheshin me masën disiplinore:

“Largim nga puna” për:

1. E. N me detyrë ish-drejtor i përgjithshëm ekzekutiv për periudhën 29.10.2005 deri në 08.10.2013, kjo masë është propozuar dhe në auditimin e mëparshëm dhe është larguar nga detyra.

2. E. H me detyrë ish-drejtor ish drejtores e njësisë së zbatimit të projektit BEI-BERZH për kalatën 7 dhe 8 për periudhën Shtator 2012 - Shkurt 2014.

“Vërejtje për Largim nga puna” për:

1. Z. D, me detyrë drejtor i DFPSH për periudhën 01.11.2013 deri 22.12.2014.

2. A. N, me detyrë përgjegjës i njësisë së sektorit të hipotekimit të pronave për periudhën 01.11.2013-13.06.2015.

D. KALLËZIM PENAL

Bazuar në kualifikimet e nenit 248 “Shpërdorimit të detyrës” bëjmë kallëzim penal për: **z. G. Sh me detyrë Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv**, pasi nga auditimi rezultuan një sërë shkeljesh të dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi të kryera nëpërmjet veprimeve apo

mosveprimeve të tij, duke i konsideruar këto veprime si veprime të kryera me dashje, me pasoja për interesat e ligjshme të Autoritetit Portual Durrës dhe të Shtetit dhe që përmbajnë elementët e figurës së veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Ligjit nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”.

Bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999, “Për informacionin e klasifikuar” i ndryshuar, Kallëzimi Penal nuk publikohet.

E. Referuar gjetjeve të konstatuara në Autoritetin Portual Durrës të shkaktuara nga veprimet dhe mos veprimet e personave të veçantë të Drejtorisë së Përgjithshme Detare, KLSH-ja do të ushtroj auditim në këtë institucion përgjatë vitit 2017 me program të rregullt auditimi, duke përfshirë të gjithë aktivitetin e këtij institucioni.

Shënim 1: Për punonjësit që aktualisht rezultojnë në marrëdhënie pune: A. Q, M. B, Z. D, A. Xh, D. G, H. H, D. P, J. R, F. Y, K. G, V. Sh, H. H, Gj. K, I. R, Y. K, A. O, F. Gj, V. Sh, E. J, K. G, A. K, Gj. K, A. L, B. S, T. S, B. M, D. Z, F. Y, K. K, E. I, L. B, B. D, O. H, A. N, A. M dhe D. P, të cilët edhe pse janë identifikuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për disa të meta e mangësi që nuk i kapërcejnë kufijtë e shkeljes administrative, për arsye se asnjë prej tyre gjatë përmbushjes së detyrave, nuk ka ndikuar negativisht apo ka sjellë pasoja të konsiderueshme në mirëfunksionimin e shoqërisë, konsiderojmë që për to, të mos propozohet masë.

Shënim 2: Në Raportin Përfundimtar të Auditimit, i jemi referuar dhe informacioneve të dhëna nga Organizata “Albanian Platform for Policy Advocacy - Platforma Shqiptare për Advokimin e Politikave” dhe Organizata “Integrimi Urban”, në lidhje me procesin e shkarkimit, depozitimit dhe evadimit të tubacioneve, materialeve të nevojshme si dhe makinerive të projektit TAP.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Investimeve dhe Projekteve me Financimet e Huaja dhe Shoqërive Publike.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R